



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31 regjistër (JR)
Datë 30.07.2020

Nr. 33 i vendimit
Datë 29.07.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 29.07.2022, ora 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 31/2020 (JR), datë 30.07.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Adnand Xhelili, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 237, datë 12.02.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 59, pika 1, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e ngritura në ankim, si dhe pasi dëgjoi në seancë gjyqësore subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij, z. Erjon Kanxheri, të cilët kërkuan përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 237, datë 12.02.2020 dhe konfirmimin e subjektit të rivlerësimit në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Adnand Xhelili, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë².
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurisë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (sikundër shprehet në vendimin e tij nr. 237, datë 12.02.2020³), kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 26.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 26.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklaratën e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³ Shih paragrafin 2, faqe 2 e vendimit të Komisionit nr. 237, datë 12.02.2020.

subjektin e rivlerësimit Adnand Xhelili, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 237, datë 12.02.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 237, datë 12.02.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit Adnand Xhelili vetëm për kriterin e pasurisë, u vërtetua se:

1. Subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “vetting”, sipas germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikave 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

2. Ka mungesë të ardhurash financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit, për shkak të një likuiditeti të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën totale prej 4.871.306 lekësh, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si rrjedhim, nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 237, datë 12.02.2020, me pretendimin se konkluzionet e nxjerra nga Komisioni në këtë vendim, janë arritur në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 4, pika 5, nenit 6 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi, me anë të të cilit Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është rezultat i një vendimmarrjeje të paragjykuar dhe njëanshmërie të dukshme.
8. Subjekti i rivlerësimit nuk e shoqëroi ankimin e tij me akte shkresore, për të cilat të kërkonte marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit Adnand Xhelili kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

- *Shqyrtimin në seancë gjyqësore publike të vendimit nr. 237, datë 12.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
- *Ndryshimin e vendimit nr. 237, datë 12.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.*

9. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

9.1. Përfundimi i procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter, atë të pasurisë, është tërësisht në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

9.2. Subjektit të rivlerësimit i është mohuar e drejta për një shërbim shëndetësor dhe kujdes mjekësor, duke e detyruar atë të marrë pjesë i sëmurë në seancën dëgjimore, edhe pse jo në gjendje fizike të tillë për të përballuar në më të mirën e tij të mundshme qoftë pyetësorët, qoftë dhe vetë ngarkesën psiko-emocionale që mbart procesi i rivlerësimit.

9.3. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

9.4. Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm.

9.5. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 49 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, për kalimin e barrës së provës, nene të cilat janë shkelur nga ana e Komisionit, pasi ky i fundit, pa dhënë arsye, nuk ka trajtuar si prova shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e tjera të dorëzuara në cilësinë e provës, duke paragjykuar procesin dhe duke cenuar standardin e një vendimi të arsyetuar.

9.6. Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), në drejtim të mosrespektimit të parimit të gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për sa kohë i njëjti komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti komision (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit në konflikt të hapur interesi, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit në një proces të rregullt gjyqësor, në kundërshtim të hapur me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.

9.7. Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së subjekteve para ligjit dhe mosdiskriminimit të tyre pasi, në raste të ndryshme rivlerësimi, ka mbajtur standarde të ndryshme lidhur me trajtimin e të ardhurave nga toka bujqësore.

9.8. Komisioni ka shkelur të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke qenë se në kundërshtim me nenin 57, pika 3, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, nuk ka shënuar orën e marrjes së vendimit, duke krijuar dyshime lidhur me autenticitetin e këtij vendimi, marrjen e tij jashtë selisë së Komisionit dhe nën ndikimin e faktorëve të jashtëm.

9.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me mungesën e bashkëpunimit të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.

9.10. Subjekti pretendoi se Komisioni, në listimin e fakteve dhe provave mbi të cilat është marrë vendimi, ka referuar edhe faktin se sipas raportit të ILDKPKI-së, subjekti është gjetur në konflikt interesi, ndërkohë që sipas tij ky fakt është i pavërtetë.

9.11. Subjekti pretendoi se vendimi përfundimtar i Komisionit nuk i është njoftuar në formë të shkruar brenda 30 ditëve nga shpallja e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "apartament banimi", me sipërfaqe 117,13 m², me adresë në rr. "{***}", Tiranë:

a) Subjekti pranoi se në deklarin e vlerës së pasurisë objekt kontrolli në deklaratën e pasurisë "vetting" ka bërë një lapsus në përlllogaritje. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk e ka zbatuar drejt parimin e proporcionalitetit në këtë rast, pasi, në mënyrë të palogjikshme, e ka lidhur pasaktësinë në deklarin e vlerës së pasurisë në deklaratën "vetting" me mungesën e të ardhurave të ligjshme.

b) Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të Komisionit lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli në drejtim të (i) mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitet e marra në analizë; dhe (ii) përlllogaritjes së të ardhurave familjare për vitin 2005.

10.2. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "shtëpi banimi" 3 x 84,3 m², me vendndodhje në Njësinë Administrative Lukovë, fshati {***}, me vlerë 9.200.000 lekë:

a) Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë "vetting", si pasojë e mosdeklarimit të pasurisë truall me sip. 570 m², si "gjykim tepër formal" dhe pa lidhje me themelin e procesit të rivlerësimit, i cili është të evidentojë rastet e fshehjes së pasurisë dhe deklarimeve të rreme.

b) Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar punimet në objekt dhe investimet e kryera në deklarimet periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010.

c) *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pamundësinë e tij dhe personave të lidhur me të, për të shlyer kredinë e marrë pranë Bankës Credins, në vlerën e 3.000.000 lekëve, me argumentin se Komisioni, në kundërshtim me parashikimet ligjore, nuk e ka vlerësuar si të ligjshme huan e marrë nga vëllai i bashkëshortes, me vlerë 18.954 USD, si dhe të ardhurat e deklaruar në mënyrë të përvitshme në DIPPV-të përkatëse, si të realizuara nga kulturat bujqësore dhe lëshimi për përdorim nga të tretë i dhomave të shtëpisë gjatë stinës së verës.*

ç) *Subjekti kundërshtoi si të pasaktë analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë 3 katëshe në {***}, në vlerën e deklaruar prej 9.200.000 lekëve, në drejtim të ndarjes në vite të shpenzimit të deklaruar si dhe të burimeve të përdorura.*

10.3. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet i tipit Volkswagen Golf”, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 210.000 lekëve:

Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe pretendoi se deri në momentin e blerjes së automjetit, ai nuk i kishte shlyer detyrimet e huas ndaj znj. B., si dhe pjesa takuese e shlyerjes së kredisë ndaj Bankës Credins ishte më e vogël nga sa i ishte përlllogaritur nga Komisioni.

10.4. Lidhur me konstatime të tjera të bëra nga Komisioni:

a) *Subjekti kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i shumës së pretenduar si përfitim nga prindërit e bashkëshortes, në vlerën e 600.000 lekëve dhe se kjo shumë nuk është deklaruar sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, kjo shumë i është dhuruar bashkëshortes së tij nga prindërit e saj si mbështetje financiare për ndërtimin e shtëpisë dhe, sipas tij, mundësitë e krijimit të kësaj shume janë të dukshme nga shpjegimet e dhëna nga vëllai i bashkëshortes, z. A. K., në deklaratën noteriale të datës 23.01.2020. Ndërkohë, sa i takon shumës prej 300.000 lekësh të deklaruar si të përdorur si burim për financimin e ndërtimit të shtëpisë, subjekti pretendoi se kjo vlerë konsistonte në të ardhura nga kursimet e bashkëshortes së tij dhe fëmijëve të tyre nga viti 2004 e në vazhdim.*

b) *Subjekti pretendoi se në kushtet e marrëdhënieve të posaçme, në kuptim të nenit 233, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, për vërtetimin e kalimit financiar të këtyre shumave, nuk është i nevojshëm një akt noterial, ndërsa lidhur me mosdeklarimin e këtyre shumave, subjekti pretendoi se bëhet fjalë për harresë apo pakujdesi dhe jo qëllim për fshehje.*

11. Në datën 26.04.2022, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit një kërkesë për marrjen e provave të reja, me objekt “Paraqitjen e akteve të ekspertimit/provave të reja: 1. Akt ekspertimi (vlerësues agronomik); 2. Akt ekspertimi kontabël; 3. Akt ekspertimi për vlerësimin e kostos reale të shpenzimeve; 4. Fotografii që kanë të bëjnë me aspekte të punës në bujqësi”. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 47 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative, kërkoi nga Kolegji pranimin e akteve të sipërcituara në cilësinë e provave të reja në gjykim.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Adnand Xhelili, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁴ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 237, datë 12.02.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
15. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, si dhe shkaqet e ankimit lidhur me konstatimin e shkeljeve të të drejtave ligjore dhe kushtetuese, si dhe atyre të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, konstatoi se gjatë procesit të rivlerësimit, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosgarantimit nga Komisioni të së drejtës për mbrojtje efektive, si pasojë e mosrespektimit të raportit mjekësor të dorëzuar nga ana e

⁴ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 237, datë 12.02.2020, për rivlerësimin e subjektit Adnand Xhelili, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 05.03.2020, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 24.03.2020, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision fillimisht në datën 20.03.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 24.03.202, dhe ridepozituar më datë 04.04.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 07.04.2020, që rezulton të jetë dita e 13 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

subjektit të rivlerësimit më datë 09.01.2020 dhe me periudhë paaftësie të përkohshme në punë, të përcaktuar nga data 08.01.2020 deri më datë 07.02.2020. Trupi gjykues çmoi se, ndodhur në kushtet e një situatë paaftësie të përkohshme të subjektit të rivlerësimit, të provuar me dokumentacion mjekësor në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, Komisioni do duhej të caktonte si datë për dorëzimin e shpjegimeve ndaj rezultateve të hetimit dhe provave përkatëse, si dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore, një datë e cila të përkonte me periudhën kohore pas përfundimit të paaftësisë së përkohshme në punë sipas raportit mjekësor, duke respektuar jo vetëm të drejtën e subjektit për kujdes shëndetësor, por mbi të gjitha duke i garantuar atij një proces të rregullt ligjor, ku ai të ishte në gjendje shëndetësore të mirë, për të mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe mbrojtur para trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Në këtë mënyrë, trupi gjykues i vlerësoi të korrigjuara gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, i çmoi të zgjidhura të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljet nga ana e Komisionit të parimeve të përgjithshme në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

16. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore dhe fotografike të depozituara në fazën e parashtrësive, trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtyre akteve, konstatoi se ato nuk ishin përcjellë në Komision gjatë procesit të rivlerësimit të kryer nga ky i fundit, ndonëse subjektit i kishte kaluar barra e provës për të provuar vlerën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga kulturat bujqësore, sikundër dhe nuk ishin dorëzuar as bashkëlidhur ankimit dhe madje as ishin referuar në ankim si akte të cilat, në pamundësi për t’u dorëzuar brenda afatit të ankimit, priteshin të dorëzoheshin në vijim. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se dy nga tri aktet e dorëzuara në Kolegj më datë 26.04.2022, mbanin përkatësisht **datat 20.02.2020 dhe 28.02.2020**, që konfirmonte faktin se ato ishin përgatitur përpara datës së përfundimit të afatit të ankimit dhe përpara datës së depozitimit të ankimit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në vijim, trupi gjykues pasi dëgjoi edhe subjektin e rivlerësimit⁵ lidhur me arsyen se përse këto akte nuk ishin dorëzuar më parë, as gjatë procedurës së zhvilluar në Komision dhe, për më tepër, as në momentin e ushtrimit të ankimit, me vendim të ndërmjetëm⁶, vendosi të refuzojë kërkesën për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provave të akteve të dorëzuara në Kolegj, në datën 26.04.2022. Kolegji arriti në këtë vendim duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se kanë ekzistuar kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, që do të legjitimonin paraqitjen e këtyre akteve me vonesë, për shkak të rrethanave që kanë ndodhur pa fajin e tij. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilave këto akte ekspertimi ai i kishte marrë nga ekspertët përpilues pas datës së dorëzimit të ankimit, ndonëse ishin përgatitur prej tyre përpara kësaj date, u vlerësuan jobindëse. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu edhe mundësinë e administrimit *ex officio* të këtyre akteve dhe arriti në përfundimin se vlera e tyre provuese dhe ndikimi i tyre në zgjidhjen e çështjes nuk është e tillë që të legjitimojë marrjen e tyre me cilësinë e provës, në zbatim të neneve 45 dhe 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

⁵ Shih përgjigjen e subjektit të rivlerësimit ora 10:45, në faqen 16 të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 26.07.2022.

⁶ Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 26.07.2022, ora 11:43, faqe 17.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter, atë të pasurisë, është tërësisht në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Sipas subjektit, në asnjë nga dispozitat e posaçme për procesin e rivlerësimit nuk parashikohet që procesi i rivlerësimit kalimtar të kryhet i bazuar vetëm në një nga kriteret e rivlerësimit, pasi kjo do të përbënte paragjykim të procesit, duke parakuptuar edhe vendimmarrjen e Komisionit. Sipas subjektit, mosgjykimi për të tria kriteret bën që, në qoftë se Kolegji do të vendoste për ndryshimin e vendimit të Komisionit që është marrë i bazuar vetëm në një kriter, bazuar në nenin F, pika 3, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji nuk mund ta kthejë atë për rishqyrtim në Komision, por do duhet të veprojë si instancë e parë dhe përfundimtare për të dyja kriteret e tjera, duke sjellë si pasojë pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për t'u ankuar ndaj këtij vendimi, për këto dy kritere dhe, rrjedhimisht, cenimin e një të drejte të subjektit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016, Kushtetuta dhe KEDNj-ja.
18. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues çmoi se pretendimi i subjektit se vendimmarrja e Komisionit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter përbën paragjykim, është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Kolegji ka arritur në këtë përfundim referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kritereve të rivlerësimit. Kjo dispozitë ligjore e vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, bën që vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, të mos jetë as paragjyquese dhe as e paracaktuar. Kjo vendimmarrje e trupit gjykues është tashmë e konsoliduar, referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit. Ndërkohë, sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se, në rastin e përfundimit të procesit nga Komisioni vetëm për një kriter, subjektit i cenohet e drejta për proces të rregullt, në eventualitetin që Kolegji ndryshon vendimmarrjen e Komisionit dhe, në kuptim të parashikimit të nenit F, pika 3, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, do duhet të veprojë si instancë e parë për shqyrtimin e dy kritereve të tjera, duke i humbur subjektit të drejtën për t'u ankuar ndaj këtij vendimi, trupi gjykues e gjen edhe këtë pretendim të pabazuar në ligj. Në kuadër të parashikimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, sipas të cilit përcaktohet shprehimisht që rivlerësimi është kompetencë kushtetuese e Komisionit dhe jo e Kolegjit, Kolegji shqyrton vetëm ankimet e subjektit të rivlerësimit apo Komisionerit Publik ndaj vendimeve të Komisionit dhe vetëm për ato kritere të cilat janë shqyrtuar në themel dhe lidhur me to është arritur në vendimmarrje përfundimtare nga ana e Komisionit. Në këtë kuptim, në eventualitetin që Kolegji ndryshon vendimmarrjen e Komisionit lidhur me kriterin e rivlerësimit mbi bazën e të cilit Komisioni ka marrë vendim, Kolegji, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit 66, pika 1, shkronja "c", vendos për prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhëron Komisionin të vazhdojë procesin e rivlerësimit për kriteret e tjera të rivlerësimit për të cilat ky i fundit nuk ka arritur në përfundim⁷. Në këtë kontekst, e drejta e subjektit për ankim lidhur me vlerësimin e këtyre dy kritereve mbetet e pacenuar.

⁷ Ky qëndrim është mbajtur nga Kolegji edhe në vendimin e tij nr. 14/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, zvj. I.B.

19. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin tashmë të konsoliduar në vendimmarrjet e Kolegjit në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi i secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
20. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 edhe në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, koncepti i deklarimit të pamjaftueshëm nënkupton sjelljen më të rëndë të mundshme në lidhje me kriterin e pasurisë, e cila duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie, sikurse janë rastet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti parashitroi se jo çdo pasaktësi e konstatuar në lidhje me vlerësimin pasuror duhet të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, pasi pasaktësitë të cilat nuk lidhen me indicie për akte korruptive, të shpërdorimit të detyrës apo dhe të rasteve të ushtrimit të detyrës në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mund të përbëjnë shkak për largimin nga detyra të subjektit, por ato duhen parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit. Në kuptim të sa më sipër, subjekti pretendoi se është cenuar parimi i proporcionalitetit nga ana e Komisionit në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
21. Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, i cili ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3, në drejtim të vlerësimit të pasaktësive në deklarime, trupi gjykues e çmon të panevojshëm trajtimin e këtij shkak ankimi në mënyrë të pavarur, për sa kohë këto pretendime, të cilat lidhen me çështje të vlerësimit të saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, janë bërë objekt verifikimi në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit, sipas shkaqeve konkrete të ngritura në ankim lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, dhe kanë gjetur trajtim në analizën përkatëse në vijim.
22. Trupi gjykues ka arritur në të njëjtin konkluzion me sa më sipër, për shqyrtimin në mënyrë të integruar me shkaqet e ngritura për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, edhe të shkakut të ankimit lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për veprime të Komisionit në kundërshtim me parashikimet e neneve 49 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, si pasojë e mostrajtit si prova të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të tjera të dorëzuara në cilësinë e provës, duke iu referuar këtu huas së marrë vëllait të bashkëshortes së tij, z. A. K., në vlerën e 18.954 USD në vitin 2011, si dhe të ardhurave të pretenduara si të realizuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2005.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), në drejtim të mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për sa kohë i njëjti Komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti Komision (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit në konflikt të hapur interesi, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit në një

proces të rregullt gjyqësor, si dhe në kundërshtim të hapur me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.

24. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin e mbajtur në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, sipas së cilave pretendime të tilla janë gjetur të pabazuara në ligj me arsyetimin se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion, për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë⁸ në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkueses lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.
25. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka cenuar parimin e barazisë së subjekteve para ligjit dhe mosdiskriminimit të tyre, pasi në raste të ndryshme rivlerësimi ka mbajtur standarde të ndryshme lidhur me trajtimin e të ardhurave nga toka bujqësore. Subjekti, në mbështetje të këtij shkakut ankimi, pretendoi se Komisioni në raste të tjera rivlerësimi, i ka marrë në konsideratë të ardhurat nga toka bujqësore, ndërkohë që në rastin e tij ato nuk janë marrë parasysh si të ardhura të ligjshme edhe pse, sipas tij, Komuna përkatëse ka vërtetuar se janë paguar të gjitha detyrimet financiare për tokën bujqësore. Subjekti kërkoi nga Kolegji marrjen në cilësinë e provave të reja të vendimeve të Komisionit nr. {***}, datë 28.01.2020 dhe nr. {***}, datë 26.07.2019, si dhe të gjitha vendimet e tjera të dala deri në datën e gjykimit të çështjes në Kolegji.
26. Në shqyrtim të shkakut të mësipërm të ankimit, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në raste të tjera, Komisioni ndryshe nga çka vlerësuar në çështjen objekt gjykimi, i ka marrë në konsideratë të ardhurat nga bujqësia, nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë apo të pavlefshëm vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij. Për rrjedhojë të sa më sipër, edhe vendimet e Komisionit për të cilat subjekti i rivlerësimit kërkoi që të merren në cilësinë e provave të reja, edhe pse mund të përbëjnë provë të faktit lidhur me vlerësimin e ndryshëm të pretenduar nga subjekti për trajtimin e të ardhurave nga bujqësia, nuk përbëjnë provë të fakteve relevante që lidhen me krijimin e këtyre të ardhurave nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, çmohen pa efekt në zgjidhjen e kësaj çështjeje.
27. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shkelje të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke qenë se sipas tij, në kundërshtim me nenin 57, pika 3, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk ka shënuar orën e marrjes së vendimit, duke krijuar në këtë mënyrë dyshime lidhur me autenticitetin e këtij vendimi, marrjen e vendimit jashtë selisë së Komisionit dhe në ndikim të faktorëve të jashtëm, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se ndonëse në vendimin e arsyetuar të Komisionit nuk referohet ora që i

⁸ Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

përket momentit të shpalljes së vendimit përfundimtar, në procesverbalin e vendimmarrjes së trupit gjykues për procesin e rivlerësimit për z. Adnan Xhelili, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, vendimi rezultoi të jetë marrë më datë 12.02.2020, ora 09:00 - 10:00. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në fakte.

28. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me mungesën e bashkëpunimit të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Subjekti i kërkoi Kolegjit të qartësojë situatën në lidhje me këtë shkak ankimi, duke vendosur përfundimisht nëse konciziteti në dhënien e përgjigjeve është shkak për të konstatuar apo jo mungesën e bashkëpunimit të subjektit të rivlerësimit.
29. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se Komisioni në vendimin e tij, është shprehur: *Z. Adnand Xhelili nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke iu përgjigjur shkurtimisht pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, ndërkohë që në disa raste nuk ka dhënë asnjë përgjigje për disa nga pyetjet e dërguara.* Nga sa referuar më sipër në vendim, Komisioni lë të kuptohet se ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, për shkak të mënyrës se si u është përgjigjur pyetjeve/pyetësorëve të Komisionit.
30. Në kuadër të kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit në këtë drejtim, trupi gjykues, pasi verifikoi të gjithë pyetësorët që i janë adresuar subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, si dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të sa më sipër, konstatoi se pavarësisht nivelit të detajimit të përgjigjeve që ka dhënë subjekti, nuk vihet re që për çështje të caktuara, Komisioni t'i ketë adresuar pyetje subjektit të rivlerësimit në mënyrë të përsëritur, çka do të konfirmonte faktin se për Komisionin, përgjigjet e dhëna nga subjekti nuk kanë qenë të kënaqshme, duke përbërë një pengesë në vijimin e procesit të hetimit administrativ. Gjithashtu, nuk u konstatua as ndonjë tërheqje vëmendjeje drejtuar subjektit të rivlerësimit në drejtim të nevojës për shpjegime të hollësishme në kuadër të detyrimit për bashkëpunim. Në çdo rast, në gjykimin e trupit gjykues, vlerësimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të sasisë së informacionit të dhënë dhe nivelit të detajimit të tij i mbart pasojat në vlerësimin e përmbushjes ose jo të barrës së provës nga ana e subjekteve dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësohet në dëm të tyre edhe në kuadër të qëndrimit bashkëpunues apo jo ndaj procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e qëndrimit të subjektit ndaj procesit të rivlerësimit, nuk gjendet i drejtë.
31. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në listimin e fakteve dhe provave mbi të cilat është marrë vendimi, ka referuar edhe faktin se, sipas raportit të ILDKPKI-së, subjekti është gjetur në konflikt interesi, ndërkohë që sipas tij, ky fakt është i pavërtetë, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se ndonëse ky pretendim ishte i drejtë dhe i bazuar në fakte në momentin e ushtrimit të ankimit, tashmë në saje të vendimit të Komisionit nr. 237/3 “Mbi korrigjimin e vendimit nr. 237, datë 12.02.2020”, rezulton të jetë i pabazuar, pasi Komisioni nëpërmjet vendimit të mësipërm, ka korrigjuar pjesën e konkluzioneve të ILDKPKI-së që rezulton të ketë pasur një referim të pasaktë.

32. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi përfundimtar i Komisionit nuk i është njoftuar në formë të shkruar brenda 30 ditëve nga shpallja e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar në fakte. Nga kontrolli i ushtruar, procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit lidhur me njoftimet e kryera nga ky i fundit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka qenë korrekt në njoftimet e kryera në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016. Vonesa e konstatuar në marrjen dijeni nga ana e subjektit, ka ardhur si pasojë e shërbimit postar dhe problematikave në gjetjen e adresës së banimit të subjektit. Për sa kohë Komisioni ka përdorur në mënyrë të saktë adresën e deklaruar nga ana e subjektit, çdo vonesë e krijuar për shkak të mosgjetjes së adresës, del përtej kontrollit të Komisionit dhe, për rrjedhojë, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

33. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 117,13 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues konstatoi si vijon.

34. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: [...] Në lidhje me pasaktësitë dhe shkaqet e mospërputhjeve në vlerat e pasurisë, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim, por si vlerë reale të pasurisë deklaroi shumën prej 1.400.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003, duke e konsideruar deklarimin për “vetting” një lapsus. Në vlerësimin përfundimtar Komisioni çmoi se, pavarësisht faktit që në kontratat me EKB-në janë pasqyruar vlera të ndryshme të pasurisë, në varësi të përlllogaritjeve për shkak të përfitimit prej statusit të të pastrehut e të të përndjekurit politik, si dhe në varësi të periudhës së pagesave, në deklaratën “vetting” subjekti duhet të deklaronte me saktësi dhe në mënyrë të detajuar vlerën e pasurisë dhe shumën e paguar prej tij për shkak të përfitimeve ligjore, mbështetur në dokumente shkresore, të cilat do të kontrolloheshin nga ky institucion, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, gjë që nuk e ka bërë, duke e bërë deklarimin të pasaktë. [...] Në lidhje me shumën e paguar për blerjen e apartamentit në vlerën prej 579.778 lekësh, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk vërtetoi të ketë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj, për shkak se: (i) gjatë periudhës 1994 – 2003, kur është paguar shuma prej 361.668 lekësh, ka rezultuar me balancë negative në shumën prej 429.913 lekësh; (ii) në vitin 2004, kur është paguar shuma prej 54.085 lekësh, ka rezultuar me balancë pozitive; dhe (iii) në vitin 2005, kur është paguar shuma prej 164.024 lekësh, subjekti ka rezultuar me balancë negative në shumën prej 193.975 lekësh. Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 117,13 m², me nr. 9/108, me adresë: rr. “{***}”, {***}, u konstatua se subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- ka kryer deklarime të pasakta në lidhje me vlerën e pasurisë;

- nuk vërtetoi bindshëm mundësinë financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e saj, sipas parashikimit të pikave 2 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

35. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ngritur në ankim për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, e mbështeti në pretendimet e mëposhtme.

35.1. Subjekti pranoi se në deklarin e vlerës së pasurisë objekt kontrolli në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka bërë një lapsus në përlllogaritje, por pretendoi se Komisioni nuk e ka zbatuar drejt parimin e proporcionalitetit në këtë rast, pasi, në mënyrë të palogjikshme, e ka lidhur pasaktësinë lidhur me vlerën e pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, me mungesën e të ardhurave të ligjshme për krijimin e saj.

35.2. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka gabuar në kryerjen e analizës financiare lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, në drejtim të mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitet e marra në analizë, si dhe përlllogaritjes së të ardhurave familjare për vitin 2005. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

(i) Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës duhet të ishte kryer sipas standardit të ILDKPKI-së, referuar INSTAT-it, dhe jo sipas Anketës së Buxhetit të Familjes, sipas njësisë ekonomiko-familjare. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se për periudhën 1993-1998, shpenzimet e jetesës kanë qenë minimale, duke qenë se familja e tij ka banuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes. Subjekti kërkoi shprehimisht nga Kolegji kryerjen/përlllogaritjen e analizës financiare të të ardhurave/shpenzimeve sipas standardeve të ILDKPKI-së.

(ii) Komisioni ka përlllogaritur shpenzime jetese të paarsyeshme, në vlerën prej 654.907 lekësh, për vitin 2005, ndërkohë që subjekti një pjesë të konsiderueshme të produkteve të shportës, pretendoi t'i ketë siguruar nga përdorimi i tokës bujqësore. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar dhe të padrejtë rezultatin e analizës financiare të Komisionit për këtë vit.

(iii) Komisioni ka përlllogaritur gabim totalin e të ardhurave familjare për vitin 2005, në vlerën e 793.430 lekëve, pasi nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të deklaruara në vlerën e 360.000 lekëve në DIPPV-në e vitit 2005. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se lidhur me këtë çështje, nuk i është kaluar barrë prove nga ana e Komisionit, në shkelje flagrante të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën për proces të rregullt, në drejtim të sigurimit të një mbrojtjeje efektive lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

36. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, fillimisht lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për moszbatim të drejtë nga ana e Komisionit të parimit të proporcionalitetit në vendimmarrje, duke qenë se sipas tij, Komisioni pasaktësinë në deklarin lidhur me vlerën e pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka lidhur me mungesën e të ardhurave të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues, pasi kontrolloi arsyetimin e Komisionit⁹ në vendimin e tij, konstatoi se pretendimi i subjektit nuk bazohet në fakte. Komisioni, ndonëse ka vlerësuar si deklarin të pasaktë deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me vlerën e apartamentit, konkluzionin tjetër të tij, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, nuk duket ta ketë lidhur me pasaktësitë në deklarin të vlerës së apartamentit.

37. Sa i takon çështjes së pasaktësisë në deklarin e vlerës së pasurisë në deklaratën *vetting*, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me krijimin e kësaj pasurie, si dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, konstatoi faktet dhe rrethanat si vijojnë.

⁹ Shih paragrafin 35 më sipër në këtë vendim.

37.1. Subjekti i rivlerësimit, deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën ka deklaruar pasurinë apartament banimi me sip. 117,13 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me vlerë 1.159.456 lekë, e ka shoqëruar me kontratën noteriale për shitje apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2005, të lidhur në prani të noteres B. H., në cilësinë e dokumentacionit justifikues që provon vërtetësinë e deklarimeve të tij në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontratë të lidhur mes Entit Kombëtar të Banesave në cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në cilësinë e blerësve, është përcaktuar shprehimisht: [...] *Të dy palët kontraktuese kanë pasur ndërmjet tyre një kontratë shitjeje me kusht me nr. {***} rep., dhe {***} kol., dt. 20.05.1999, të redaktuar prej meje, noteres. Sipas të dhënave të palës shitëse, vlera reale e këtij apartamenti është 1.618.081 lekë. Mbi bazën e kësaj kontrate, nga pala blerëse janë kryer këto pagesa: është paguar shuma prej 40.000 lekësh, që përfaqëson pagesën fillestare. Është paguar shuma prej 62.675 lekësh, që përfaqëson vlerën e shpenzimeve operacionale (4%). Janë paguar këstet, në bazë të kontratës së shitjes me kusht të cituar më sipër, deri në mars të vitit 2005, në shumën prej 326.500 lekësh. Gjithashtu, mbi bazën e kësaj kontrate, nga pala shitëse janë zbritur punimet e kryera deri në dt. 31.12.1992, në bazë të VKM-së nr. 291, dt. 21.06.1994, në shumën prej 123.275 lekësh. Meqenëse pala blerëse ka statusin e të përndjekurit politik, sipas shkresës nr. {***}, dt. 03.06.2004, i takon banesa falas. Meqenëse sipas certifikatës familjare të paraqitur pranë palës shitëse, rezulton me sipërfaqe tepër prej 37,13 m², pala blerëse paguan dhe vlerën e kësaj sipërfaqeje në shumën prej 579.778 lekësh. Përfundimisht, palës blerëse i mbetet për të paguar shuma prej 150.503 lekësh, e cila është likuiduar totalisht “cash” nga pala blerëse, sipas mandatarkëtimit nr. {***}, dt. 30.03.2005.*

37.2. Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar ndër të tjera edhe depozitimi i kontratës së shitjes me kusht të apartamentit të përmendur në kontratën e shitjes së datës 30.03.2005. Referuar kësaj kontrate të dorëzuar nga subjekti së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se lidhur me çmimin e apartamentit dhe pagesën e tij, përcaktohej shprehimisht: *Vlera e apartamentit është 1.618.081 lekë. Nga vlera e apartamentit, bëhet kjo zbritje: a) Meqenëse blerësi ka statusin e të pastrehut, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, dt. 21.06.1994 dhe udhëzimit nr. 4, dt. 21.06.1994, i zbriten punimet e kryera deri më 31.12.1992, në masën 123.175 lekë. b) Sipas zbritjeve të mësipërme, çmimi i apartamentit është 1.494.806 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi, blerësi ka paguar me dokumentin nr. {***}, datë 25.10.1996 dhe nr. {***}, dt. 27.10.1997, pagesën fillestare me vlerën 40.000 + 40.000 = 80.000 lekë dhe pagesën me dokumentin nr. {***}, datë 16.10.1997, me vlerën 62.675 lekë, pagesa 4%. Për shlyerjen e vlerës së plotë të çmimit të shitjes së apartamentit, blerësit i mbetet të paguajë detyrimin prej 1.352.131 lekësh, në përputhje me kushtet dhe afatet e kredisë së dhënë nga shitësi [...].*

38. Në analizë të fakteve të konstatuara më sipër, trupi gjykues vëren se deklarimi i vlerës së apartamentit nga ana e subjektit në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së, në mars të vitit 2004, është kryer në përputhje me vlerën e pasurisë sipas dokumentacionit ligjor të krijimit të saj, “Kontratës së shitjes me kusht” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.1999. Ndërkohë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar si vlerë të apartamentit shumën prej 1.159.456

lekësh, e cila, referuar dokumentacionit ligjor të krijimit të pasurisë, nuk përcaktohet as si vlerë e kësaj pasurie dhe as rezulton nga ndonjë përlllogaritje konkrete si vlerë reale. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë se, referuar dokumentacionit justifikues ligjor, vlera e paguar realisht nga subjekti për blerjen e apartamentit nga Enti Kombëtar i Banesave, është shuma prej 579.778 lekësh, vlerë kjo dukshëm më e vogël sesa deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* (prej 1.159.456 lekësh), trupi gjykues e vlerëson si një shpjegim bindës, sqarimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit që në shpjegimet e tij rreth rezultateve të hetimit administrativ, konfirmuar edhe në përmbajtjen e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, se në deklarimin e vlerës së pasurisë objekt kontrolli në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka bërë një lapsus, si pasojë e përlllogaritjeve jo të sakta.

39. Trupi gjykues, në mbështetje të plotë të argumentimit të Komisionit, se në kuadër të procesit të rivlerësimit subjekti kishte detyrimin ligjor për të deklaruar me saktësi vlerën e pasurisë objekt kontrolli, vlerëson se në interpretim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më sipër, pasaktësia e evidentuar në rastin konkret, me deklarimin si vlerë të pasurisë të një vlere inekzistuese, referuar akteve të krijimit të pasurisë, njëkohësisht edhe më të lartë se ajo e paguar realisht nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund ta vendosë këtë të fundit në kushtet e një deklarimi të pasaktë, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion jo vetëm se në një vlerësim logjik të situatës, që deklarimi i një vlere më të madhe sesa paguar realisht, hedh poshtë dyshimet për “pasaktësi” të qëllimshme nga ana e subjektit, por mbi të gjitha në faktin se duke qenë se deklarata e pasurisë *vetting* është shoqëruar në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me dokumentacionin justifikues “Kontratë e shitjes së apartamentit” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2005, ku u konstatua se detajohej në mënyrë të plotë jo vetëm vlera reale e apartamentit, por edhe pagesat e kryera dhe zbritjet e përfituara në saje të përfitimeve sipas akteve ligjore e nënligjore të kohës, në vlerësimin e trupit gjykues, i ka krijuar Komisionit të gjitha mundësitë për të verifikuar në mënyrë të hollësishme krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, kur pasaktësia në deklarim nuk është kthyer në pengesë për ushtrimin e një kontrolli të plotë nga Komisioni, trupi gjykues çmoi se deklarimi i pasaktë i vlerës së kësaj pasurie nuk sjell pasoja në kontrollin e kryer lidhur me këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë më vete si shkak për vlerësimin e deklarimit të subjektit për këtë pasuri, si deklarim i pamjaftueshëm, në kuadër të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
40. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për analizë financiare të gabuar nga ana e Komisionit, trupi gjykues, pasi kontrolloi, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën e kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, si dhe shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e gabuar nga Komisioni të të ardhurave dhe shpenzimeve, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
41. Pas kontrollit të kryer nga ana e Njesisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se metodologjia e përdorur nga ana e Komisionit në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën e viteve 2000-2003, nuk ishte në përputhje me standardin e ndjekur nga Kolegji në vendimmarrje të mëparshme, në lidhje me përlllogaritjen e këtij zëri të analizës financiare, sipas treguesve statistikorë për konsumin vjetor dhe mujor për frymë, sipas INSTAT-it. Nga përlllogaritja e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, sipas treguesve të sipërcituar statistikorë, rezultoi se shpenzimet e jetesës për periudhën e viteve 2000-2003 për 4 persona, janë përkatësisht në vlerat 432.000 lekë për vitin 2000, 375.456 lekë për vitin 2001, 375.456 lekë për vitin 2002 dhe 375.456 lekë për vitin 2003, të cilat vihet re të jenë më të ulëta se vlerat e përlllogaritura dhe të identifikuara nga Komisioni në analizën e tij për periudhën në fjalë. Ndërkohë, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën para vitit 2000, për të

cilat nga kontrolli i vendimit të Komisionit, rezultoi se ky i fundit i kishte përlllogaritur ato sipas raportit 80% të të ardhurave nga paga, trupi gjykues pranoi si të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritjen e tyre në masën e 66% të të ardhurave, duke rezultuar në këtë mënyrë në ulje të masës së shpenzimeve të jetesës për periudhën e viteve 1994-1999, nga 1.406.808 lekë llogaritur fillimisht nga Komisioni, në 1.323.309 lekë.

42. Gjithashtu, nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, u konstatua se të ardhurat nga paga për subjektin e rivlerësimit, për vitet 1994 dhe 1995, nuk ishin përlllogaritur në mënyrë të saktë, pasi rezultoi që nga Komisioni për këto dy vite, nuk ishin përlllogaritur në zërin e pagave, pagesat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit sipas vërtetimit të punëdhënësit¹⁰, përkatësisht në vlerat e 92.351 lekëve për vitin 1994 dhe 154.151 lekëve për vitin 1995, në total për të dyja vitet në shumën prej 246.502 lekësh.
43. Në përfundim të sa më sipër, nga rishikimi i analizës financiare të Komisionit në dritën e konkluzioneve të arritura si më sipër, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, rezultati i analizës financiare të Komisionit për vitet 1994 – 2003, nga pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme në vlerën e 429.913 lekëve, u përmirësua në favor të subjektit të rivlerësimit, duke rezultuar me një vlerë negative të papërfillshme, prej vetëm 32.182 lekësh.
44. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për rezultat të gabuar dhe të padrejtë të analizës financiare të Komisionit për vitin 2005, në drejtim të përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në mënyrë të paarsyeshme, në vlerën prej 654.907 lekësh, duke qenë se sipas tij, një pjesë e konsiderueshme e produkteve të shportës pretendohet t'i ketë siguruar nga përdorimi i tokës bujqësore dhe produkteve të siguruar prej saj, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se ky pretendim mbeti në nivel deklarativ. Për këtë arsye, përlllogaritja nga Komisioni e zërit të shpenzimeve të jetesës sipas metodologjisë së ndjekur sipas të dhënave të INSTAT-it, pas verifikimit të kryer nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi e saktë dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, u gjet i pabazuar në fakte.
45. Lidhur me pretendimet që ka ngritur subjekti i rivlerësimit në drejtim të mosmarrjes në konsideratë nga Komisioni të të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2005, si dhe pretendimit për cenim të procesit të rregullt ligjor në drejtim të moskalimit të barrës së provës lidhur me këtë çështje, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në DIPPV-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit në rubrikën e të ardhurave dhe angazhimeve private dhe publike, kishte deklaruar: [...] *Paga vjetore e bashkëshortes, e punësuar në sektorin privat - vlera 360.000(treqind e gjashtëdhjetë mijë).*
46. Ndërkohë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e angazhimeve dhe veprimtarive private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe të ardhurat e deklaruara ndër vite nga bashkëshortja e tij, znj. M. Xh., nga analizimi i të cilave konstatohet se për periudhën nga muaji gusht 1998 deri më 14.07.2006, nuk ka deklarim për angazhime dhe veprimtari të kryera nga znj. Xh. Për rrjedhojë, as të ardhura të deklaruara për bashkëshorten e tij për këtë periudhë kohore.
47. Gjithashtu, edhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, sa u takon të ardhurave të krijuara nga ana e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nuk u konstatua ndonjë dokumentacion që provon faktin e pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit,

¹⁰ Shih shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse nr. {***}, datë 25.10.2016.

as sa i takon punësimin në sektorin privat të bashkëshortes së tij, sikundër deklaruar në DIPPV-në e vitit 2005, as të të ardhurave të deklaruara dhe të pretenduara si të krijuara në të njëjtin vit, në masën e 360.000 lekëve.

48. I pyetur nga trupi gjykues në seancë gjyqësore në Kolegj, lidhur me punësimin në sektorin privat të bashkëshortes për këtë periudhë, si dhe arsyes së mosdeklarimit të këtij fakti të pretenduar në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti u përgjigj: “Bashkëshortja ime ka qenë e punësuar te dajat e vet dhe e ka përfituar këtë shumën te tregu pranë Farmacisë {***}. Daja quhet Z. M. [...]. Ka qenë si të thuash e paregjistruar, e padeklaruar. Nuk e di arsyen pse s’është pasqyruar. Në deklaratën *vetting*, meqenëse kemi marrë vetëm pagat e gjithë personave familjarë nga institucionet shtetërore, është më tepër lapsus mendoj që s’është pasqyruar”.
49. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se me të drejtë, Komisioni nuk i ka përlloritur këto të ardhura në analizën financiare të vitit 2005, jo vetëm sepse këto të ardhura nuk ishin deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, por mbi të gjitha për faktin se nga hetimi i kryer në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, rezultoi se këto të ardhura të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2005, mbetën në nivel deklarativ dhe për to nuk u konstatua asnjë dokumentacion justifikues që të provonte krijimin e tyre. Për më tepër, sikundër u deklarua dhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, këto të ardhura rezultuan të ishin krijuar në kuadër të një marrëdhënieje informale punësimi dhe, për rrjedhojë, edhe në eventualitetin që do të provohej krijimi i tyre, ato nuk do të mund të vlerësoheshin të ardhura të ligjshme për efekt të këtij procesi, duke u përfshirë në analizën financiare të vitit përkatës, për sa kohë nuk do mund të përmbushnin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
50. Sa i takon pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit, lidhur me vlerësimin e këtyre të ardhurave, Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove, në shkelje flagrante të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën për proces të rregullt, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme, konstatoi se lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si të krijuara nga bashkëshortja e tij në vitin 2005, nuk është pasqyruar në mënyrë të posaçme në rezultatet e hetimit administrativ ndonjë analizë lidhur me këto të ardhura, megjithatë vihet re se Komisioni ka qenë i qartë në kalimin e barrës së provës për mosvlerësimin e të ardhurave të pretenduara si të ardhura të ligjshme, në kuadër të analizës financiare përmbledhëse për periudhën 2003-2016, të paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ, ku rezultati negativ prej 6.668.241 lekësh vinte edhe si pasojë e balancës negative të vitit 2005, prej 193.975 lekësh, ku të ardhurat nga paga të bashkëshortes së subjektit ishin llogaritur shprehimisht në zërin përkatës, në vlerën 0 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt si pasojë e moskalimit të barrës së provës lidhur me vlerësimin e këtyre të ardhurave, është i pabazuar në fakte. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte krijimin e këtyre të ardhurave sipas standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, edhe pasi u dëgjua lidhur me këtë çështje nga trupi gjykues në seancë gjyqësore publike.
51. Trupi gjykues vlerësoi po ashtu të pabazuar në fakte edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të standardit të arsyetimit të vendimit në drejtim të mostrajtitimit në vendim të të ardhurave të bashkëshortes në vlerën e 360.000 lekëve, të deklaruara si të realizuara në vitin 2005, në kushtet kur këto të ardhura: (i) çmohet se nuk janë pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të për t’u përfshirë në analizën e kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit, sa kohë nuk janë deklaruar nga ana e tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*; dhe (ii) nuk janë kundërshtuar dhe as provuar si të ardhura të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit në

shpjegimet e tij as pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e analizës financiare për periudhën e vlerësimit 2003-2016, pjesë e së cilës ishin edhe të ardhurat objekt kontrolli në rubrikën që i takonte vitit 2005. Në kuptim të sa më sipër, analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2005, mbetet e pandryshuar.

52. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në konsideratë të rezultatit të analizës financiare lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, vetëm në lidhje me pagesën e kryer për shlyerjen e kështit të kredisë së EKB-së në vitin 2005.
53. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “shtëpi banimi” 3 x 84,3 m², me vendndodhje në Njësinë Administrative Lukovë, fshati {***}, me vlerë 9.200.000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuara konkluzionet e Komisionit lidhur me krijimin e saj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
54. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive, ndër të tjera, si vijon: *Në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me objektin 3-katësh në fshatin {***}, Sarandë, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:*
- *Nuk ka deklaruar pasurinë nr. {***}, truall me sip. 570 m² në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në deklaratën “vetting”, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 84/2016 (shtojca 2) dhe pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
 - *Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008, 2009 dhe 2010, nuk ka deklaruar në lidhje me punimet në objekt dhe investimet e kryera. [...]*
- Pavarësisht përpjekjeve të subjektit për të vërtetuar me dokumente shkresore burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. A. K., për të justifikuar dhënien e shumës prej 18.594 USD në vitin 2011, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës, për të vërtetuar huan në shumën prej 18.594 USD, marrë nga z. A. K., si burim i ligjshëm për shlyerjen e kredisë, për shkak se:*
- *Subjekti nuk ka deklaruar në lidhje me këtë hua edhe detyrimin financiar ndaj shtetasit A. K. në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe në asnjë prej deklarimeve në vijim, sipas detyrimit ligjor parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.*
 - *Në deklaratën “vetting”, subjekti nuk ka deklaruar huan dhe asnjë fakt në lidhje me shlyerjen e saj apo detyrimin financiar për shkak të saj, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 30 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
 - *Mosdeklarimi sipas detyrimeve ligjore në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “vetting”, i detyrimit financiar ndaj z. A. K., si dhe mungesa e deklarimeve në lidhje me shlyerjen e këtij detyrimi, do të thotë që subjekti e ka shlyer këtë hua. Vlen për t’u theksuar fakti që edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka ngritur pretendime në lidhje me shlyerjen ose jo të*

huas. Sa i takon mundësisë për shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme, edhe pse nuk ka të dhëna për periudhat/periudhën e shlyerjes së huas, nga analiza financiare ka rezultuar se gjatë vitit 2011 kur është dhënë huaja, si dhe pas këtij viti, subjekti ka rezultuar me balanca negative, si rrjedhim, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e huas. Subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me huan prej 18.594 USD marrë nga z. A. K. në vitin 2011, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit dhe, për rrjedhojë, huaja nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për shlyerjen e një pjese të kredisë, marrë nga Credins Bank.

*[...] Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni konstatoi se subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe nga dhënia e shtëpisë në fshatin {***} për turizëm, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016, pasi:*

- ka deklarime të pasakta në lidhje me këto të ardhura;*

- nuk vërtetoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave, në shumën 8.170.000 lekë, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në sa më sipër, në lidhje me kredinë e marrë në Credins Bank, subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk vërtetoi mundësinë financiare të shlyerjes së saj me të ardhura të ligjshme.*

[...] Lidhur me të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe nga turizmi, subjekti nuk vërtetoi ligjshmërinë e tyre (trajtuar si më sipër) dhe, si rrjedhim, ato nuk janë përfshirë si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare përfundimtare.

*[...] Si rrjedhim, subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për investimin prej 9.200.000 lekësh në objektin 3-katësh në fshatin {***}, Sarandë, për shkak të një difference të pajustificuar me të ardhura të ligjshme, në shumën 1.974.731 lekë.*

55. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi si vijon.

55.1. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në atë të pasurisë *vetting*, si pasojë e mosdeklarimit të pasurisë truall me sip. 570 m², si “gjykim tepër formal” dhe pa lidhje me themelin e procesit të rivlerësimit, i cili, sipas tij, është të evidentojë rastet e fshehjes së pasurisë dhe deklarimet e rreme. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit sqaroi se mosdeklarimi i tokës në deklaratën e pasurisë *vetting*, përbën një mungesë vëmendjeje dhe se duke pasur të deklaruar ndërtesën në {***}, me deklarimin e ndërtesës ka nënkuptuar të përmbushur edhe detyrimin për deklarimin e truallit mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa. Në lidhje me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit sa i takon mosdeklarimit të kësaj pasurie (tokës “truall”) në DIPPV-në e vitit 2012, subjekti shpjegoi se parcela nga ka rrjedhur dhe sipërfaqja e tokës objekt diskutimi janë deklaruar prej tij rregullisht në DIPPV-në e vitit 2009, nëpërmjet deklarimit të bashkëpronësisë mbi pasuritë e fituara sipas Aktit të Marrjes së Tokës në pronësi nr. {***}, datë 01.10.1995.

55.2. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ai nuk ka deklaruar punimet në objekt dhe investimet e kryera në deklarimet periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010. Subjekti kundërshtoi gjithashtu si të pabazuar edhe rezultatin financiar me teprica pozitive në vitet 2008 dhe 2009, si dhe atë të vitit 2010 me mungesë burimesh të ligjshme, dhe këtë pretendim e mbështeti në faktin se, sipas tij, në vitet 2008 dhe 2009 janë kryer shpenzime në kuadër të përgatitjeve për ndërtimin e shtëpisë së banimit prej 3 katesh, për rrjedhojë ai pretendoi se të ardhurat e disponueshme kanë shkuar për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos krijuar

kursime apo teprica pozitive. Subjekti kundërshtoi gjithashtu si të pasaktë analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të mjaftueshme për ndërtimin e shtëpisë 3-katëshe në {***} në vlerën e deklaruar prej 9.200.000 lekësh, në drejtim: (i) të ndarjes në vite të shpenzimit të deklaruar, si dhe të burimeve të përdorura; (ii) të përlllogaritjes në mënyrë të gabuar si vlerë të ndërtimit të shtëpisë, vlerën prej 9.200.000 lekësh, ndërkohë që një pjesë e kësaj vlere, shuma prej 1.600.000 lekësh, është vlere e arredimit të saj. Në këtë kuadër, subjekti pretendoi se duke qenë se në shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it, mobilimi paraqitet si zë i veçantë, i përfshirë në vlerat e përlllogaritura nga Komisioni, shpenzimet e arredimit nuk mund të përlllogariten edhe si pjesë e shpenzimeve të jetesës, edhe si shpenzime të veçanta, dhe kërkoi nga Kolegji korrigjimin e përlllogaritjeve në kuptim të sa më sipër.

55.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pamundësinë e tij dhe atë të personave të lidhur me të për të shlyer kredinë e marrë pranë Bankës Credins, në vlerën e 3.000.000 lekëve, me argumentin se Komisioni, në kundërshtim me parashikimet ligjore, nuk e ka vlerësuar si të ligjshme huan e marrë nga vëllai i bashkëshortes, me vlerë 18.954 USD, si dhe të ardhurat e deklaruara në mënyrë të përvitshme në DIPPV-të përkatëse, si të realizuara nga kulturat bujqësore dhe lëshimi për përdorim nga të tretët i dhomave të shtëpisë 3-katëshe në {***} gjatë stinës së verës. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtoi:

- a) Sa i takon huas së marrë nga kunati, z. A. K., subjekti e kundërshtoi si të padrejtë dhe abuzive mosmarrjen në konsideratë të kësaj huaje të marrë me qëllim shlyerjen e një pjese të kredisë së marrë pranë Bankës Credins, në vlerën e 3.000.000 lekëve, dhe argumentoi se Komisioni nuk e ka bazuar në fakte dhe në prova konkluzionin për mungesë të burimeve të ligjshme të shumës së dhënë hua, pasi sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka analizuar në vendim asnjë nga provat e dorëzuara nga ana e subjektit lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të shumës së dhënë hua nga ana e vëllait të bashkëshortes së tij. Lidhur me mosdeklarimin e huas në deklaratimet periodike, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti argumentoi se deklaratimet që ka bërë ai gjatë procesit lidhur me marrjen e kësaj huaje, përputhen plotësisht me verifikimet që ka bërë Komisioni dhe se mosdeklarimi i këtij fakti në deklarata, është rezultat i mungesës së vëmendjes. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kushtet që kjo hua ka shërbyer si një e ardhur për subjektin e rivlerësimit në vitin kur është marrë, do të ishte alogjik mosdeklarimi i saj me dashje, pasi në këtë mënyrë do të ulëshin të ardhurat e ligjshme të tij. Për rrjedhojë, subjekti kërkoi nga Kolegji vlerësimin e këtij mosdeklarimi si pasaktësi në deklaram, e cila nuk mund të çojë në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.
- b) Sa u takon të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga toka bujqësore dhe përdorimi i ambienteve të objektit 3-katësh gjatë stinës së verës nga pushuesit për turizëm, subjekti pretendoi se:
 - i. këto të ardhura janë deklaruar rregullisht në deklaratimet periodike të viteve në të cilat janë realizuar;
 - ii. sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin e çështjes¹¹, vërtetohet se z. Adnan Xhelili është banor autokton i fshatit {***}, Njësia Administrative Lukovë, dhe se ai ka në pronësi tokë bujqësore, në të cilën kultivon kultura të ndryshme të zonës, ndërkohë që gjatë stinës së verës ai i lëshon dhomat e tij për turizëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, në këto dokumente të cilat, sipas tij, referuar nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, përbëjnë provë të plotë, vërtetohet se ai ka shlyer rregullisht të gjitha detyrimet e taksave vendore, ndërkohë që

¹¹ Subjekti i referohet vërtetimit nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Njesisë Administrative Lukovë, si dhe vërtetimit të kryetarit të Bashkisë Himarë nr. {***} prot., datë 22.01.2020.

sa i takon tatimit mbi të ardhurat personale nga kulturat bujqësore dhe shtëpia, nga Njësia Administrative dhe Bashkia Himarë nuk janë vjelë deri më tani tatime lidhur me këto lloj të ardhurash.

iii. tatimi mbi të ardhurat personale të krijuara nga sa më sipër, nuk është vjelë as nga Njësia Administrative Lukovë dhe as nga Bashkia Himarë për të gjithë banorët e zonës të cilët merren me agroturizëm, në kuadër të politikave për të nxitur zhvillimin e agroturizmit, pasi dhe referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të ardhurat e siguruara nga vetëpunësimi në bujqësi nuk konsiderohen të ardhura të tatueshme, arsyetim ky i cili, sipas subjektit, është përdorur nga Komisioni në vendimet e tij nr. 191, datë 26.07.2019 dhe nr. 229, datë 28.01.2020.

56. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, fillimisht sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në paragrafin 55.1 më sipër, në drejtim të kundërshtimit si të gabuar të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë në DIPPV-në e vitit 2012, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* të pasurisë objekt kontrolli, si pasojë e mosdeklarimit të pasurisë të llojit tokë “truall” me sip. 570 m², nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

56.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, ka deklaruar: 2. *Shtëpi banimi, 3 x 84,3 m², fshati {***}, Njësia Administrative Lukovë, viti 2008-2010. [...] 5. Tokë, sipërfaqja 12.000 m², {***}-Sarandë, burimi i krijimit: Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, si anëtar i familjes bujqësore.* Ndërkohë, sa u takon deklarimeve periodike pranë ILDKPKI-së, lidhur me krijimin e pasurisë së llojit tokë bujqësore, vihet re se në vitin 2009, subjekti ka deklaruar: *Me hyrjen e zonës në sistem, regjistruar në emër të f. bujqësore me k. familjar Sh. Xh., tokë, sipas ligjit nr. 7501, sip. 12.000 m², nga kjo unë zotëroj 1/3 pjesë. Aktualisht në bashkëpronësi të gjithë ish-familjes bujqësore, sipas frymëve, mua si familje më takon 1/3, d.m.th. 4000 metra katrorë.*

56.2. Referuar akteve të fashikullit të përcjellë pranë Komisionit nga ana e ILDKPKI-së, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vërtetësinë e deklarimit të sipërcituar në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka justifikuar me dokumentacionin që ka shoqëruar deklaratën e pasurisë *vetting* dhe konkretisht me kopje të 11 certifikatave për vërtetim pronësie¹².

¹² Kopjet e certifikatave për vërtetim pronësie që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “*vetting*”, janë:

- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Adnand Sh. Xhelili, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Apartament {***}”, me sipërfaqe totale 84,39 m², nga kjo 190 m² truall, 84,39 m² ndërtesë, me datë lëshimi 25.02.2014.*
- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Adnand Sh. Xhelili të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Apartament {***}”, me sipërfaqe totale 84,39 m², nga kjo 190 m² truall, 84,39 m² ndërtesë, me datë lëshimi 25.02.2014.*
- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Adnand Sh. Xhelili të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Apartament {***}”, me sipërfaqe totale 84,39 m², nga kjo 190 m² truall, 84,39 m² ndërtesë, me datë lëshimi 25.02.2014.*
- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 300 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore + Ullishte”, me sipërfaqe totale 2500 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*

56.3. Gjatë procedurës së hetimit administrativ në vijim të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe certifikatën e gjendjes familjare nr. {***}, datë 11.10.2019, me anë të së cilës vërtetohet përbërja familjare më datë 01.08.1991, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte pjesë e familjes Xhelili, me kryefamiljar z. Sh. Xh. dhe, për rrjedhojë, bashkëpronar i pasurisë së llojit “tokë bujqësore”, të përfitur me AMTP nr. {***} akti, datë 01.10.1995, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”. Gjithashtu, referuar të dhënave të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit pranë regjistrimit të pasurive të paluajtshme, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Sarandë, në vijim të kërkesës së Komisionit për sqarim të rrethanave të regjistrimit të truallit me sip. 570 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit, është shprehur¹³ si vijon: *Pasuria me sipërfaqe 570 m² e llojit truall, fillimisht ka qenë e regjistruar në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore, z. Sh. H. Xh., e përfitur prej saj me anë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. {***} akti, datë 01.10.1995, [...] e pasqyruar në volumnin {***}, faqe {***}, me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe prej 1400 m², sipas aktit [...]. Me anë të referencës me nr. {***} dokumenti, është bërë ndarje pasurie nr. {***} vol. {***}, f. {***} dhe për sipërfaqen prej 570 m², është hapur kartela e pasurisë me nr. {***} vol. {***}, f. {***}. Me anë të referencës me nr. {***} dokumenti dhe të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.06.2012, të noteres L. T., pasuria me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, me sipërfaqe prej 570 m² pemëtore, ka kaluar në pronësi të z. Adnand Sh. Xhelili.*

56.4. Ndërsa në urdhrin “Për regjistrim fillestar” nr. {***}, datë 25.02.2014, të regjistruarit të ZVRPP-së Sarandë, është përcaktuar: *Urdhëroj regjistrimin e objektit “Godinë banimi 3KT”, me vendndodhje në ZK {***}, shkallë që i përket fshatit {***}, me sipërfaqe 570 m², me nr. pasurie {***}, me zë kadastral truall, nga e cila ndërtime me sipërfaqe të bazës 96 m², sipërfaqe ndërtimi 84,39 m² për çdo kat x 3 kate = 253,17 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 11,61 m² çdo kat x 3 kate = 34,83 m². Gjithashtu, mendojmë që të hapen kartelat e pasurisë për apartamentet përbërëse të godinës 3-katëshe, një apartament për çdo kat, si më poshtë: apartamenti {***}, kati {***}, P. nr. {***}, me sipërfaqe trualli që i takon 190 m², apartamenti {***} [...].*

-
- *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 1300 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
 - *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 350 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
 - *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 400 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
 - *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Arë”, me sipërfaqe totale 3000 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
 - *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 1600 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*
 - *Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore, të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë Sarandë-{***}, lloji “Pemëtore”, me sipërfaqe totale 1000 m², me datë lëshimi 25.09.2009.*

¹³ Shih shkresën e Drejtorisë Vendore Sarandë nr. {***} prot., datë 01.11.2019.

57. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vuri re se sa i takonte vlerësimit të deklarimit të subjektit në vitin 2012, kur konstatohet se ka ndodhur kalimi i pronësisë për pasurinë me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, me sipërfaqe prej 570 m², lloji “Pemëtores”, sipas kontratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.06.2012, të noteres L. T., nga prindërit e subjektit të rivlerësimit të ky i fundit, ky fakt juridik nuk rezultoi të jetë deklaruar nga ana e subjektit në DIPPV-në e këtij viti. Ndonëse bashkëpronësia e subjektit të rivlerësimit mbi tokën bujqësore nga e cila ka rrjedhur parcela e kaluar në pronësi të tij në vitin 2012, është deklaruar që në vitin 2009, ky fakt juridik i ndodhur në vitin 2012, në kuadër të individualizimit të parcelës, sipërfaqes dhe kufijve të kësaj pasurie për të cilën subjekti tashmë është kthyer në pronar të vetëm, si dhe të ndryshimeve të sipërfaqes së pasurisë në bashkëpronësi, do duhej të ishte deklaruar në DIPPV-në e vitit 2012, në kuadër të një deklarimi të plotë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, i ndryshuar, lidhur me pasqyrimin e ndryshimeve të pasurive dhe interesave të tij privatë.
58. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk ka deklaruar me përpikëri pasuritë e paluajtshme në kuptim të deklarimit të të dhënave të tyre, sipas certifikatave përkatëse të pronësisë, të cilat ai i ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës *vetting*, në cilësinë e dokumentacionit justifikues. Pavarësisht kësaj, nga analizimi i fakteve të cituara më sipër dhe të dhënave lidhur me pasurinë e llojit tokë bujqësore dhe ndryshimet e pësuar përgjatë viteve, konstatohet se subjekti nuk ka munguar të deklarojë në deklaratën *vetting* ndonjë pasuri e cila të ketë qenë në pronësi të tij në momentin e deklarimit. Përkundrazi, edhe pasuritë e regjistruara në emër të të atit në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, për të cilat subjekti ka deklaruar pjesëmarrjen në bashkëpronësi në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, i ka deklaruar të gjitha në tërësinë e tyre, si pasuri e llojit “tokë”, me sipërfaqe totale prej 12.400 m², referuar aktit të marrjes së tokës në pronësi (madje pa përjashtuar as pasurinë me nr. {***}, me sipërfaqe prej 570 m², për të cilën që nga viti 2012, është bërë pronar i vetëm dhe mbi të cilën ka ndërtuar godinën me 3 kate), dhe jo sipas të dhënave të certifikatave individuale të pronësisë, sipas parcelave respektive, akte këto të cilat i kishte depozituar rregullisht dhe i kishte vënë në dispozicion të Komisionit.
59. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht se subjekti do duhej të kishte treguar një kujdes të shtuar në lidhje me deklarimin e hollësishëm të secilës pasuri në pronësi a bashkëpronësi të tij, sipas të dhënave të tyre, referuar dokumentacionit ligjor përkatës, subjekti nuk rezultoi të ketë munguar të deklarojë në deklaratën e pasurisë *vetting*, pronësinë mbi pasurinë e llojit “tokë truall” me sipërfaqe 570 m², për sa kohë kjo pasuri, referuar fakteve të sipërcituara, në momentin e plotësimit nga subjekti të deklaratës *vetting*, ekzistonte në formën e një godine 3-katëshe, e ndërtuar mbi truallin në fjalë, i cili kishte shërbyer si shesh ndërtimi, duke e shndërruar pasurinë e llojit “tokë truall” në pasuri të llojit “Apartament 1, 2 dhe 3 [...]”, secila prej tyre me sipërfaqe ndërtese 84 m² dhe sipërfaqe trualli funksional prej 190 m². Për rrjedhojë, ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe vlerësimi i Komisionit për deklarim të pasaktë të pasurisë objekt 3-katësh në fshatin {***}, për shkak të mosdeklarimit në deklaratën *vetting* të pasurisë nr. {***}, të llojit tokë “truall”, me sip. 570 m², është i pabazuar.
60. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me vlerësimin e mosdeklarimit prej tij në DIPPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010 të punimeve dhe investimeve të kryera në objekt si deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, me pretendimin se nuk ka qenë në kushtet e një detyrimi ligjor për deklarim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në drejtim të deklarimeve të subjektit për këto vite, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

61. Komisioni duket që konkluzionin e tij për deklaram të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit për pasurinë objekt kontrolli, bazuar në parashikimin kushtetues të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, me të drejtë e ka trajtuar në kontekst të vlerësimit të të dyja shtyllave të kriterit të pasurisë, konkretisht verifikimit të saktësisë dhe plotësisë së deklaramit të kryer nga ana e subjektit lidhur me këtë pasuri, si dhe të kontrollit lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për ta krijuar atë. Në këtë kontekst, sa i takon vlerësimit të saktësisë së deklarameve të subjektit të rivlerësimit për pasurinë objekt kontrolli, Komisioni, sikundër referuar dhe më sipër në vendim, ka konkluduar: [...] *Për sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me objektin 3-katësh në fshatin {***}, Sarandë, subjekti ka kryer deklaramve të pamjaftueshme, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:*
- *Nuk ka deklaram pasurinë nr. {***}, truall me sip. 570 m², në deklaramtën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në deklaramtën “vetting”, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë [...]*
 - *Në deklaramat periodike vjetore për vitet 2008, 2009 dhe 2010 nuk ka deklaram në lidhje me punimet në objekt dhe investimet e kryera.*
62. Referuar sa më sipër, konstatohet se Komisioni i ka atribuuar subjektit të rivlerësimit konkluzionin për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë “objekt 3-katësh në fshatin {***}, Sarandë”, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në problematika të cilësuar prej tij në kontekstin e vlerësimit të deklaramit të subjektit në drejtim të saktësisë, plotësisë dhe përputhshmërisë së tij me ligjin, ku vihet re të ketë identifikuar në mënyrë të shprehur ndër to edhe mosdeklaramin në deklaramat periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010 të punimeve të ndërtimit dhe investimeve të kryera në këtë objekt. Në analizë të sa më sipër, Kolegji çmon se ky arsyetim i Komisionit nuk është i drejtë dhe se ky i fundit, deklaramet apo mosdeklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramat periodike, në drejtim të viteve në të cilat ka kryer punimet e ndërtimit për ngritjen e objektit 3-katësh, duhet t’i kishte trajtuar në kontekstin e analizës dhe kontrollit të burimeve të ligjshme të përdorura nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, duke fokusuar objektin e kontrollit në drejtim të provueshmërisë së fakteve lidhur me vitet e deklaramara në deklaramtën e pasurisë *vetting* dhe të pretenduara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, në të cilat, sipas tij, janë kryer punimet e ndërtimit dhe rrjedhimisht pretendohet të jenë investuar vlera monetare të padeklaramara në vlerë konkrete, me qëllim verifikimin në vijim të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të disponueshme për justifikimin e këtyre punimeve.
63. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se mosdeklarami në deklaramat periodike të viteve 2008, 2009 dhe 2010 nga subjekti i rivlerësimit, i faktit që në këto vite ka kryer punime për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, duke investuar në këtë objekt, nuk mund të ndikojë në vlerësimin e saktësisë së deklaramit të pasurisë së paluajtshme objekt 3-katësh në {***}-Sarandë, me pasojë vlerësimin e deklaramit të tij si të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarami i këtyre fakteve duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni në drejtim të mosprovueshmërisë së pretendimeve të subjektit lidhur me periudhën e ndërtimit dhe shpërndarjes së vlerave të investuara në këto vite. Në vijim të këtij konkluzioni, trupi gjykues çmoi si deklaramtiv, të pabazuar në fakte, pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin si të pabazuar të rezultatit financiar me teprica pozitive në vitet 2008 dhe 2009, si dhe atë të vitit 2010 me mungesë burimesh të ligjshme, me justifikimin se, sipas tij, në vitet 2008 dhe 2009 ishin kryer shpenzime në kuadër të përgatitjeve për ndërtimin e godinës 3-katëshe dhe se të ardhurat e disponueshme kishin shkuar për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos krijuar kursime apo teprica pozitive. Trupi gjykues konstatoi se në asnjë akt të fashikullit të çështjes të administruar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk kishte përcaktuar vlerën e shpenzimeve të kryera në këto vite, si dhe se vlerat e pretenduara për herë të parë në ankimin e tij si shpenzime, përkatësisht vlera

prej 490.000 lekësh në vitin 2008 dhe vlera prej 784.169 lekësh në vitin 2009, nuk u arritën të provohen prej tij as gjatë gjykimit në Kolegj. Trupi gjykues, në vlerësim të dinamikës së deklaramëve të subjektit lidhur me këto shpenzime, konstatoi se vlerat monetare konkrete, si më sipër cituar, u pretenduan pas konkluzioneve të Komisionit lidhur me analizën financiare të kryer për vitet 2008, 2009 dhe 2010 dhe, për rrjedhojë, u konsideruan si një kundërshtim *post factum* i analizës financiare të Komisionit dhe jo si deklarime të cilat pasqyrojnë në mënyrë reale një shpenzim që në momentin e kryerjes së tij, duke u vlerësuar për këtë arsye, si të pabesueshme. Në vijim të sa më sipër, rezultati i analizës financiare të kryer nga ana e Komisionit, mbeti i pandryshuar në drejtim të alokimit në vite dhe në vlera të shpenzimeve të ndërtimit dhe, për rrjedhojë, tepërcat pozitive në analizën e Komisionit, nuk mund të kompensojnë rezultatin negativ të analizës financiare të vitit 2010.

64. Sa i takon pretendimit të subjektit për përlllogaritje të gabuar të vlerës prej 9.200.000 lekësh, si vlerë të ndërtimit të shtëpisë, duke qenë se një pjesë e kësaj vlere, shuma prej 1.600.000 lekësh, i takon arredimit, i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, është kryer ndër vite, trupi gjykues arriti në përfundimin se ky pretendim është pa efekt në zgjidhjen e çështjes, sa kohë ndarja apo jo e vlerës së arredimit nga vlera e objektit nuk sjell asnjë pasojë në analizën financiare të Komisionit përderisa shpenzimi i pretenduar i arredimit, prej 1.600.000 lekësh, është deklaruar nga vetë subjekti si pjesë e vlerës së objektit në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe analiza financiare rezulton të jetë kryer në përputhje me vlerën e deklaruar nga vetë subjekti. Pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se, duke qenë se në shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it, mobilimi paraqitet si zë i veçantë i përfshirë në vlerat e përlllogaritura nga Komisioni, shpenzimet e arredimit nuk mund të përlllogariten edhe si pjesë e shpenzimeve të jetesës, edhe si shpenzime të veçanta, duke kërkuar për rrjedhojë nga Kolegji korigjimin e përlllogaritjeve në kuptim të sa më sipër, u vlerësua nga trupi gjykues si pretendim i pabazuar. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi verifikoi metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga INSTAT-i dhe zërin që u takon shpenzimeve të mobilimit. Nga verifikimet e kryera nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në bazën e të dhënave publike në faqen zyrtare në internet të INSTAT-it, trupi gjykues konstatoi se në shpenzimet e jetesës, INSTAT-i ka përfshirë edhe një zë që u takon shpenzimeve të mobilimit, të cilat janë të ndara në nëngrupe shpenzimesh (të tilla si: mobilie, tapete, tekstile shtëpie, pajisje shtëpie, ngrohës dhe kondicionerë, qelqurina, si dhe mallra dhe shërbime për mirëmbajtje shtëpie). Nga verifikimet e Njesisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi se këto shpenzime mobilimi për vitin 2010, referuar të dhënave të INSTAT-it, rezultonin në vlerën e 28.417 lekëve. Kjo vlerë rezultoi e papërfillshme në raport me shpenzimin e deklaruar nga subjekti si vlerë arredimi për shtëpinë në {***}, prej 1.600.000 lekësh, për të justifikuar pretendimin e mospërlllogaritjes dy herë të shpenzimeve të arredimit. Megjithatë, edhe nëse do të merrej në konsideratë nga ana e trupit gjykues kjo shumë në përlllogaritje, efekti i saj në analizën financiare të vitit 2010, vlerësohet i papërfillshëm në drejtim të ndryshimit të rezultatit të saj në favor të subjektit të rivlerësimit.
65. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me vlerësimin që i ka bërë Komisioni huas së pretenduar si të marrë në vitin 2011 nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., vëllait të saj, z. A. K., në vlerën e 18.594 USD, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
66. Gjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar se nëpërmjet shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave me nr. {***}prot., datë 12.03.2019, është raportuar se në emër të znj. M. Xh., bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, është kryer një

transaksion bankar më datë 18.02.2011, pranë Bankës Credins, me përshkrim: *Derdhje, hua e marrë nga shtetasi A. K., në vlerën e 18.594 USD.*

67. Nga verifikimi i kryer në Kolegj në lëvizjet e llogarisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Credins, konstatohet se në datën 18.02.2011, në këtë llogari është kryer prej saj një depozitim *cash* në monedhën USD, në vlerën prej 18.594 USD, me përshkrimin: *Derdh Xh. M., hua marrë A. K.* Sipas këtij përshkrimi, rezulton se depozitimin e vlerës *cash* prej 18.594 USD e ka kryer vetë znj. M. Xh. në llogarinë e saj, dhe jo z. A. K., sikundër konstaton Komisioni në vendimin e tij¹⁴ dhe konfirmon edhe subjekti i rivlerësimit. Në vijim, kjo vlerë e konvertuar në monedhën lekë¹⁵, në masën e 1.900.000 lekëve, është urdhëruar nga znj. Xh. për shlyerjen e pjeshme të kredisë së marrë pranë kësaj banke në vitin 2009, në vlerën e 3.000.000 lekëve. Kjo kredi rezultoi të jetë shlyer përfundimisht në muajin prill të vitit 2013.
68. Nga verifikimi i deklaratave periodike të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, u vu re se në deklaratën periodike të vitit 2011, kur pretendohet të jetë marrë huaja nga z. A. K., si dhe në deklaratat në vitet pasuese, nuk konstatohen deklarime të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave të tretë. Gjithashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk rezultoi ndonjë deklarim i subjektit të rivlerësimit apo i bashkëshortes së tij lidhur me ekzistencën e një detyrimi të pashlyer (ekzistues) në momentin e dorëzimit të kësaj deklaratë.
69. Gjatë hetimit administrativ në Komision, më konkretisht në fazën e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit, ky i fundit, në kundërshtimin e gjetjeve të Komisionit lidhur me huan e pretenduar nga kunati i tij, ka depozituar një deklaratë noteriale të z. A. K., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2020, para noteres M. J., sipas së cilës z. K. deklaron: *Për nevoja të shlyerjes së një kredie të marrë pranë Credins Bank, me qëllim ndërtimin e një shtëpie banimi në truallin e bashkëshortit të saj në fshatin {***} të rrethit Sarandë, i kam vënë në dispozicion motrës sime, M. Xh., vlerën monetare në shumën 18.594 dollarë, shumë të cilën e kisha të depozituar pranë Bankës Amerikane në periudha të ndryshme kohore [...]. Së bashku me këtë deklaratë, me qëllim përmbushjen e barrës së provës lidhur me mundësinë e vëllait të bashkëshortes për të dhënë hua vlerën e pretenduar të cilën deklaron se ky i fundit e ka pasur të depozituar pranë Bankës Amerikane, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar ndër të tjera edhe 3 kontrata të depozitave bankare të z. A. K. pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë. Më konkretisht: (i) kontratën e depozitës bankare të datës 23.06.2006, me vlerë prej 10.000 USD, me afat maturimi 1-vjeçar në datën 25.06.2007; (ii) kontratën e depozitës bankare të datës 26.12.2007, me vlerë prej 3.000 USD, me afat maturimi 1-vjeçar, në datën 26.12.2008; (iii) kontratën e depozitës bankare të datës 13.05.2008, në vlerën 4.000 USD, me afat maturimi 1-vjeçar në datën 13.05.2009.*
70. I pyetur nga trupi gjykues gjatë gjykimit në Kolegj, lidhur me vijimësinë e kësaj marrëdhënieje të pretenduar huaje mes huadhënësit A. K. dhe znj. M. Xh., personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ky i fundit është përgjigjur: *Duke qenë vëllai i bashkëshortes sime dhe këtë veprim bashkëshortja e ka bërë me iniciativën e vet dhe me mirëkuptim me të vëllain e saj, edhe për shkak se vëllai saj ka qenë i hapur në kuptimin për ta ndihmuar sepse, duke pasur dhe disa prona, nga të cilat bashkëshortja ime nuk përfiton, domethënë, në momentin që ka kaluar kjo shumë në favor të bashkëshortes sime për shlyerjen e kredisë pranë Credins Bank, kjo gjendje vazhdon. Pra, nuk është shlyer akoma. Ndërsa sa i takon arsyet së mosdeklarimit të këtij detyrimi financiar në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti është përgjigjur se bëhet fjalë për një lapsus, harresë.*

¹⁴ Shih paragrafin e fundit "b" në faqen 18 të vendimit të Komisionit nr. 237, datë 12.02.2020.

¹⁵ Shuma prej 18.594 USD është konvertuar në datën 18.02.2008 në Credins Bank, në vlerën 1.896.588 lekë, me kursin e ditës USD/lekë = 102.

71. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më sipër, trupi gjykues çmoi fillimisht se arsyetimi i Komisionit lidhur me vlerësimin e marrëdhënies së pretenduar të huas mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të saj, paraqitet kontradiktor. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion pasi vëren se, nga njëra anë Komisioni duket sikur arsyeton se subjekti nuk provoi marrjen e kësaj huaje, pasi nuk e kishte deklaruar atë më parë, as në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, ndërkohë nga ana tjetër, në mënyrë të pakuptimtë, si pasojë e të njëjtit fakt, mosdeklarimit të detyrimit financiar ndaj të kumatit në deklaratën e pasurisë *vetting*, duket sikur Komisioni pranon shlyerjen e kësaj huaje (të papranuar fillimisht) në vitet në vazhdim. Në vijim, pasi konstaton pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për ta shlyer atë me burime të ligjshme, Komisioni arrin në konkluzionin përfundimtar për deklarim të pamjaftueshëm të kësaj huaje. Në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni duhet të ishte më i qartë në drejtim të analizës ligjore të fakteve dhe duhet të qartësonte subjektin e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të kësaj marrëdhënieje huaje në raport me kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur kjo marrëdhënie huaje nuk ishte deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* (dhe sikundër rezultoi gjatë hetimit as në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së), që të mund t'i nënshtrohej zbatimit të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e tij dhe, për rrjedhojë, Komisioni të vlerësonte mundësinë e personit tjetër të lidhur, z. A. K., për të justifikuar me të ardhura të ligjshme vlerën e pretenduar si të dhënë hua, do duhej që më parë të provohej ekzistenca e kësaj marrëdhënieje huaje.
72. Në drejtim të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se marrja e kësaj huaje nuk ishte deklaruar në mënyrë vullnetare nga ana e subjektit të rivlerësimit as në deklaratimet periodike dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikull, nuk rezultoi asnjë e dhënë që të mund të provonte faktin se vlera monetare e depozituar *cash* nga znj. M. Xh. në llogarinë e saj bankare, ishte një hua e marrë nga vëllai i saj A. K., përveç përshkrimit të vendosur prej saj në momentin e depozitimit të kësaj shume. Edhe kontratat e depozitave bankare të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, u çmuan pa ndikim në vlerësimin e kësaj çështjeje, sa kohë informacioni që ato mbartnin jepte një pasqyrim të këtyre depozitave në datën e çeljes së tyre dhe ato nuk paraqisnin: (i) as të dhëna në drejtim të një tërheqjeje fondesh nga ana e z. A. K., në kohën dhe vlerën e pretenduar të huas dhe, më së paku, (ii) as ekzistencën në depozitën në emër të z. K., të një vlere monetare të përafërt me atë të depozituar nga znj. Xh. në periudhën kur pretendohet të jetë dhënë huaja. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për vlerësimin e kësaj huaje si burim i ligjshëm të ardhurash për shlyerjen e pjesshme në vitin 2011, të kredisë së marrë pranë Bankës Credins, është i pabazuar në fakte, pasi marrëdhënia e huas nuk u arrit të provohet se ka ndodhur. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për shlyerjen e pjesshme në vitin 2011, të kredisë së marrë pranë Bankës Credins në vitin 2009, të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “shtëpi banimi me sip. 3 x 84,3 m²”.
73. Në analizë të pretendimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit të pasqyruara në paragrafin 55.3 (b) më sipër në vendim, lidhur me të ardhurat e deklaruara si të krijuara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore dhe përdorimi i ambienteve të objektit 3-katësh gjatë stinës së verës nga pushuesit për turizëm, vlerësuar këto në raport dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi si vijon.
74. Komisioni, në vendimin e tij, ka arsyetuar lidhur me këto të ardhura: *Lidhur me të ardhurat nga kulturat bujqësore, subjekti, përveç se nuk paraqiti asnjë dokument për të vërtetuar të kundërtën*

e barrës së provës, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar: “Këto të ardhura të deklaruara sipas viteve, nuk mund të konsiderohen fitime, pasi përveç shlyerjes së pagesave të taksave vendore pranë Njësisë Administrative Lukovë, pjesa më e madhe e tyre kanë shkuar për mirëmbajtjen, punimin, ujitjen dhe plehërimin e kulturave”. Si rrjedhim, referuar këtij deklarami, si dhe mungesës së dokumentacionit justifikues për vërtetimin e të ardhurave konkrete, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore pas kalimit të barrës së provës, Komisioni nuk konsideroi asnjë vlerë si të ardhur ligjore, përfituar prej tokës bujqësore (vresht, ullinj dhe agrume në fshatin {***}). Së dyti: lidhur me të ardhurat nga turizmi, subjekti nuk paraqiti asnjë dokument për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk vërtetoi pagimin e detyrimeve tatimore, me qëllim legjitimitimin e tyre si të ardhura të ligjshme. Përveç kësaj, deklarimi i të ardhurave nga turizmi për shkak të dhënies me qira të dhomave të objektit 3-katësh në fshatin {***}, Sarandë, në periudhën 2010 – 2016, nënkupton ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e turizmit, aktivitet për të cilin nuk u vërtetua që subjekti apo ndonjë prej anëtarëve të familjes të jetë regjistruar në organet tatimore. Por, pavarësisht kësaj, në të dyja format që mund të ketë realizuar të ardhura, qoftë si individ, qoftë si subjekt tregtar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e pagimit të detyrimeve tatimore, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, detyrim i cili nuk rezultoi të jetë përmbushur.

75. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore (vresht, ullinj, agrume në {***}), vlerën prej 8.170.000 lekësh. Deklarimin e tij, subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar me vërtetimin e Njësisë Administrative Lukovë datë 17.10.2016, në të cilin thuhet: *Me anë të të cilit vërtetojmë se z. Adnand Xhelili, me shtëpi banimi në fshatin {***}, në Njësinë Lukovë, Bashkia Himarë, ka shlyer në mënyrë të përvitshme detyrimet e taksave vendore. Ndërkohë, në deklaratimet e tij përpara ILDKPKI-së për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore (vresht, ullinj, agrume), si dhe nga shfrytëzimi i shtëpisë për turizëm në {***}/shfrytëzimi i shtëpisë me qira gjatë stinës së verës, respektivisht vlerat 1.850.000 lekë, 1.570.000 lekë, 1.200.000 lekë, 1.350.000 lekë, 900.000 lekë, 800.000 lekë, ndërsa në vitin 2016 ka deklaruar vetëm të ardhura nga toka bujqësore (vresht, ullinj, agrume), në vlerën e 500.000 lekëve.*
76. Në kuadër të proceseve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në korrespondencën e kësaj të fundit me Njësinë Administrative Lukovë¹⁶, me qëllim verifikimin e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit nga kulturat bujqësore dhe shfrytëzimi i banesës gjatë stinës së verës, i cili si konstatuar më sipër, në disa vite është referuar si aktivitet qiraje, në disa vite si shfrytëzim i banesës për turizëm, Njësia Administrative Lukovë ka informuar se z. Adnand Xhelili nuk ka të deklaruar asnjë qiradhënie të pasurive të paluajtshme (shtëpi pushimi) pranë këtij institucioni. Ndërsa në komunikimin e datës 30.03.2018, Njësia Administrative Lukovë është shprehur: *Ish-komuna Lukovë, deri në vitin 2015, përfshirë këtu edhe sezonin turistik të atij viti, nuk ka evidentuar dhe vjelë në gjithë territorin e saj asnjë detyrim për sa u përket dhomave nga shtëpitë e banimit që lëshoheshin për turizëm vetëm për sezonin e verës. Pra, subjekti Adnand Xhelili ka shlyer detyrimet siç ua kemi dërguar të tokës bujqësore, taksës së banesës, tarifave bashkiake (gjelbërim dhe pastrim) dhe truallit të shtëpisë.*

¹⁶ Sipas komunikimit me e-mail, të datës 29.03.2018.

77. Ndërsa nga komunikimi i ILDKPKI-së me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë¹⁷, kjo e fundit informon se, referuar të dhënave të sistemit c@ts të kësaj drejtorie, ka rezultuar se as subjekti i rivlerësimit dhe as personat e lidhur me të, përfshirë edhe i ati i subjektit të rivlerësimit, z. Sh. Xh., nuk janë të regjistruar pranë DRT Sarandë dhe, për pasojë, nuk ka asnjë të ardhur apo detyrim tatimor pranë kësaj drejtorie në emër të tyre.
78. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga trupi gjykues lidhur me deklarin e këtyre të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i turizmit dhe kulturave bujqësore në Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (në vijim “DIVA”) pranë organit tatimor, në kuadër të detyrimit ligjor për deklarimin e të ardhurave personale të krijuara gjatë një viti kalendarik për të gjitha subjektet, të ardhurat bruto të të cilave nga të gjitha burimet, kalojnë vlerën totale prej 2.000.000 lekësh, u shpreh: *Asnjë vit mendoj unë, nuk ka pasur të ardhura mbi 2.000.000 (dy milionë) lekë. Asnjë vit për sa i përket shfrytëzimit të këtyre mundësive, nuk ka pasur të ardhura mbi 2.000.000 lekë.* Subjekti pohoi se këto të ardhura i ka deklaruar çdo vit pranë ILDKPKI-së, por nuk ka kryer asnjë deklarin në DIVA. Në verifikim të këtij deklarimi të subjektit të rivlerësimit në seancë, trupi gjykues konstatoi se për vitet 2012¹⁸ e në vazhdim, në të cilat subjekti ka deklaruar të ardhura me burim aktivitetin e turizmit dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore, totali i të ardhurave individuale të subjektit të rivlerësimit nga të gjitha burimet e të ardhurave, e kalonte vlerën prej 2.000.000 lekësh, të përcaktuar si prag minimal për efekt të deklarimit të të ardhurave pranë organit tatimor.
79. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues arriti në përfundimin se për të ardhurat e pretenduara si të krijuara nga veprimtaritë e mësipërme dhe të deklaruara si të tilla në DIPPV-të përkatëse dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk është administruar gjatë hetimit administrativ asnjë provë e faktit të realizimit të këtyre veprimtarive¹⁹, të masës së këtyre të ardhurave të pretenduara, si dhe se, lidhur me këto të ardhura, nuk rezulton të jetë paguar ndonjë detyrim tatimor në formën e tatimit mbi të ardhurën apo tatimit mbi fitimin.
80. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues çmoi të nevojshme marrjen në analizë edhe të kuadrit ligjor që përcakton detyrimet e subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari në këto fusha. Për rrjedhojë, fillimisht sa u takon të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti i turizmit për shkak të dhënies me qira të dhomave të objektit 3-katësh, rezultoi se referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, një ndër taksat vendore të cilat administrohen nga pushteti vendor, është edhe taksa e fjetjes në hotel. Referuar nenit 26 të të njëjtit ligj, për qëllime të këtij ligji, me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, përcaktim ky që përfshin edhe aktivitetin e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndonëse rezulton që të mos jetë regjistruar pranë organit tatimor për ushtrimin e një aktiviteti të tillë²⁰. Sipas të njëjtit nen, detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli dhe derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.
81. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se fakti që pranë Njesisë Administrative Lukovë, nuk rezulton të jetë derdhur asnjë pagesë takse hoteli, referuar parashikimit ligjor për ushtrimin e

¹⁷ Nëpërmjet shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë nr. {***} prot., datë 03.04.2018.

¹⁸ Vit në të cilin është vendosur detyrimi për plotësimin e DIVA-s.

¹⁹ Përveç disa fotografive që tregojnë subjektin e rivlerësimit të angazhuar në punë me natyrë bujqësore.

²⁰ Të pohuar edhe gjatë seancës gjyqësore publike në Kolegj. Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 26.07.2022.

aktivitetit të pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit, përbën gjithashtu provë të mosushtrimit të veprimtarisë së pretenduar në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, çdo e ardhur e krijuar në kuadër të një aktiviteti të tillë, bazuar edhe në sa më sipër konstatuar, me të drejtë është vlerësuar nga ana Komisionit se nuk përmbush standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues çmoi se përmbajtja e komunikimit të datës 30.03.2018²¹, mes Njësisë Administrative Lukovë dhe ILDKPKI-së, sipas së cilës referohet: *Ish-komuna Lukovë, deri në vitin 2015, nuk ka evidentuar dhe vjelë në të gjithë territorin e saj asnjë detyrim për sa u përket dhomave nga shtëpitë e banimit që lëshoheshin për turizëm vetëm për sezonin e verës*, nuk ndikon në vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, sa kohë përjashtimi nga vjelja e këtyre taksave vendore, referuar nenit 6 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006²², nuk rezultoi se mbështetet as në parashikimet e këtij ligji, as në ndonjë një akt tjetër ligjor. Konkluzioni i mësipërm e bën të panevojshme analizën e mëtejshme në drejtim të verifikimit nëse të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet i ushtruar nga subjekti i rivlerësimit u nënshtrohen apo jo detyrimeve të tjera me natyrë tatimore, për sa kohë, për nevojat e procesit të rivlerësimit, u arrit të provohet se të ardhurat e deklaruar si të krijuara nga shfrytëzimi i shtëpisë së banimit në fshatin {***} për turizëm, nuk përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, edhe në eventualitetin që do të provohej masa e të ardhurave me burim aktivitetin turistik.

82. Ndodhur në këto kushte, ku: (i) subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së i ka deklaruar të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në mënyrë të integruar me të ardhurat nga shfrytëzimi i shtëpisë së banimit për turizëm, të cilat nuk u gjenden me burim të ligjshëm; dhe (ii) gjatë procesit në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të identifikojë, të përcaktojë apo të veçojë vlerën e këtyre të ardhurave, sipas burimeve përkatëse; trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të paplotë të këtyre të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Si pasojë e këtij deklaratimi të pasaktë dhe të paplotë, trupi gjykues u ndodh në pamundësi objektive për të kontrolluar vlerën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruar me burim shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe, për rrjedhojë, vlera e deklaruar prej 1.850.000 lekësh, si e krijuar në vitin 2010, me burimet e sipërcituara, nuk mund të shërbejë si e ardhur e ligjshme për efekt të shpenzimeve për ndërtimin e pasurisë “shtëpi banimi, 3 x 84,3 m²”, me vendndodhje në fshatin {***}, në këtë vit. Gjithashtu, në tërësi, të ardhurat e pretenduara me të njëjtin burim, nuk mund të vlerësohen si burim i ligjshëm për shlyerjen e kredisë së marrë pranë Bankës Credins.
83. Në përfundim të shqyrtimit të shkakut të ankimit që lidhet me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “shtëpi banimi me sip. 3 x 84,3 m²”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Lukovë, fshati {***}, me vlerë 9.200.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
84. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar në fakte të analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit*

²¹ Përmbajtja e së cilës konfirmohet edhe në vërtetimin e kësaj njësie të datës 24.10.2019, të depozituar si provë nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

²² Neni 6 i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, përcakton shprehimisht: “Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta. Për përjashtimet nga taksat vendore, të cilat aplikohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushteti vendor do të kompensohet për efektet financiare nga Buxheti i Shtetit”.

të rivlerësimit për krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit “automjet i tipit Volkswagen Golf”, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 210.000 lekëve, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

85. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie: *Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në lidhje me pasurinë autoveturë me targa {***}, u konstatua se janë kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:*
 - *Nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit në vitin 2013, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.*
 - *Nuk u vërtetua bindshëm burimi financiar me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
86. Në kundërshtimin si të pabazuar në fakte të analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit pretendoi se deri në momentin e blerjes së automjetit, ai nuk i kishte shlyer detyrimet e huas ndaj znj. B., si dhe se pjesa takuese e shlyerjes së kredisë ndaj Bankës Credins, ishte më e vogël nga sa i ishte përlogaritur nga Komisioni.
87. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikullin e çështjes, konstatoi se pagesat e kryera deri në datën 28.06.2009 (datë në të cilën rezultoi të jetë blerë automjeti) për shlyerjen e kredisë së marrë pranë Bankës Credins në vitin 2009, kapnin vlerën totale prej 1.010.250 lekësh. Konkretisht, referuar lëvizjeve bankare në llogarinë e pagës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Credins, rezultoi se pagesat e kryera raportohen si vijon: znj. M. Xh. ka paguar nga llogaria e pagës këstet e kredisë pranë Credins Bank në datën 21.01.2013, shumën prej 12.476 lekësh; në datën 20.02.2013, shumën prej 9.509 lekësh; në datën 01.03.2013, shumën prej 2.978 lekësh; dhe në datën 20.03.2013, shumën prej 12.476 lekësh. Në datën 08.04.2013, bashkëshortja e subjektit, pasi ka depozituar *cash* në llogarinë e saj rrjedhëse të pagës, shumën prej 965.000 lekësh, ka proceduar me shlyerjen e pjesës së mbetur të kredisë në vlerën prej 972.810 lekësh, duke e mbyllur përfundimisht këtë detyrim me Bankën Credins.
88. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përlogaritjen e pagesës së shlyerjes së kredisë në shumën prej 405.235 lekësh, me arsyetimin se kjo është pjesa takuese e kësteve për 5 muaj, deri në muajin maj 2013, pasi makina është blerë në fund të qershorit të këtij viti dhe se kësti për muajin qershor paguhet në korrik, është i pabazuar në fakte. Përlogaritja e Komisionit rezultoi të jetë bazuar në pagesat e kryera, sa kohë një fakt i tillë ishte i provueshëm nga të dhënat e lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.
89. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit shlyerja e detyrimit të huas ndaj znj. B., prej 600.000 lekësh, e deklaruar në DIPPV-në 2013, është bërë në fund të vitit dhe jo brenda 6-mujorit të parë, trupi gjykues vëren se ndonëse ky pretendim mbeti në nivel deklarativ, edhe nëse ai do të pranohej si i vërtetë, sërish analiza financiare e kryer për efekt të vlerësimit të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, do të rezultonte me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në vlerën e rreth 526.644 lekëve.
90. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku të ankimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë së luajtshme të llojit “automjet i tipit Volkswagen Golf”, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 210.000 lekëve, është i drejtë dhe i bazuar

në fakte dhe në ligj, për sa kohë, nga shqyrtimi i çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

91. Lidhur me shkakun e ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit, sipas të cilit nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i shumës së pretenduar si përfitim nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në vlerën e 600.000 lekëve dhe se kjo shumë nuk është deklaruar sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti pretendoi se kjo shumë i është dhuruar bashkëshortes së tij nga prindërit e saj, si mbështetje financiare për ndërtimin e shtëpisë dhe se, sipas tij, mundësitë e krijimit të kësaj shume ishin të dukshme nga shpjegimet e dhëna nga vëllai i bashkëshortes, z. A. K., në deklaratën noteriale të datës 23.01.2020. Nga verifikimi i kryer në funksion të vlerësimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se një fakt i tillë nuk provohet nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit në Komision, si dhe as gjatë gjykimit në Kolegj dhe, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbeti në nivel deklarativ. Në këto kushte, vlerësimi i Komisionit lidhur me këto të ardhura, u gjet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj.
92. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se shuma prej 300.000 lekësh, e deklaruar si e përdorur si burim për financimin e ndërtimit të shtëpisë, konsiston në të ardhura nga kursimet e bashkëshortes së tij dhe fëmijëve të tyre nga viti 2004 e në vazhdim, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se në deklaratimet ndër vite pranë ILDKPKI-së, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe në vijim, fëmijët e tyre, nuk kanë deklaruar kursime në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, të disponueshme për t'i përdorur si burim për financimin e ndërtimit të shtëpisë në periudhën 2008-2010, sikundër dhe nuk rezultoi e deklaruar në vitin 2010 nga ana e subjektit të rivlerësimit, në momentin e deklaratimit të pasurisë objekt kontrolli, pakësimi i gjendjes së likuiditetit në *cash*. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit se si burim për financimin e ndërtimit të pasurisë “godinë me 3 kate”, është përdorur edhe vlera prej 300.000 lekësh, si kursim i bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre, sa kohë ky pretendim mbeti në nivel deklarativ.
93. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, referuar konkluzioneve të arritura nga trupi gjykues si më sipër në këtë vendim, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën e vlerësimit 2003-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, në vlerën e 4.355.281 lekëve.
94. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 237, datë 12.02.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, kam ndarë mendim paralel ndaj arsyetimit të shumicës, lidhur me zbatimin e ligjit dhe të procedurës përgjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në Kolegj.
2. Fillimisht, vlerësoj të rëndësishëm të theksoj detyrimin ligjor që subjektet e rivlerësimit kanë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës e ligjit nr. 84/2016, neni 31, pika 1 [*shtojca* 2], për të deklaruar në mënyrë të saktë e të plotë pasuritë, të ardhurat e ligjshme e shpenzimet sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, si në deklaratat e interesave privatë periodikë dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.
3. Përgjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat e përfituara nga aktiviteti agrobujqësor dhe nga hoteleri-turizëm, duke i deklaruar në vlera të përbashkëta për gjithë periudhën 2010-2015, gjë e cila e bëri të vështirë përcaktimin në terma ligjorë dhe ekonomiko-financiarë të të ardhurave dhe pamundësoi përcaktimin e fitimit konkret për secilin aktivitet [bujqësi, turizëm] e, për rrjedhojë, edhe përfshirjen në analizën ekonomike financiare për subjektin e rivlerësimit.
4. Pavarësisht pasaktësive të konstatuara, subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore publike në Kolegj, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore të paraqitura bashkëlidhur ankimit, kërkesë e cila u refuzua nga shumica e trupit gjykues me vendim të ndërmjetëm. Në vendimin për mosmarrjen e këtyre akteve në cilësinë e provës, shumica e trupit gjykues ka arsyetuar se: [...] *pasi dëgjoi edhe subjektin e rivlerësimit lidhur me arsytet se përse këto akte nuk ishin dorëzuar më parë, as gjatë procedurës së zhvilluar në Komision dhe, për më tepër, as në momentin e ushtrimit të ankimit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të refuzojë kërkesën për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provave të akteve të dorëzuara në Kolegj, në datën 26.04.2022 [...] subjekti i rivlerësimit nuk provoi se kanë ekzistuar kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, që do të legjitimonin paraqitjen e këtyre akteve me vonesë, për shkak të rrethanave që kanë ndodhur pa fajin e tij. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilave këto akte ekspertimi ai i kishte marrë nga ekspertët përpilues pas datës së dorëzimit të ankimit, ndonëse ishin përgatitur prej tyre përpara kësaj date, u vlerësuan jobindëse [...].*
5. Në vlerësimin tim, vendimi i ndërmjetëm i shumicës së trupit gjykues është i gabuar, pasi nuk i garantoi subjektit të rivlerësimit, që në mënyrë shteruese të ushtronte të drejtën e tij për t'u mbrojtur nëpërmjet argumenteve dhe akteve të depozituara, duke e cenuar në këtë mënyrë procesin e rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit në vlerësimin tim, u privua nga e drejta e tij për të provuar me dokumentacion ligjor pretendimin lidhur me të ardhurat e përfituara nga bujqësia e të deklaruara ndër vite, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, kanë shërbyer për krijimin e pasurisë në fshatin {***}, Sarandë. Ky moment ligjor dhe procedural, për mua si gjyqtare, përbën një moment kyç, për t'i dhënë zgjidhjen e plotë dhe të drejtë kësaj çështjeje. Për këtë arsye, kam votuar për marrjen në cilësinë e provës të akteve ligjore të paraqitura nga subjekti, pasi i shërbenin përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave në kuadër të nenit 49, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, që legjitimon marrjen nga Kolegji të dokumenteve të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj, me qëllim zgjidhjen e drejtë të çështjes.

6. Në vijim të analizës, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kuadër të zgjidhjeve të çështjeve të rivlerësimit, në nenin 4, pika 6, adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshje administrative” i ndryshuar.

Megjithatë, pavarësisht kërkesave të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, që legjitimojnë paraqitjen e provave të reja në ankim, që janë ezauruese dhe të qarta, çmoj se në procesin e rivlerësimit duhen mbajtur në konsideratë disa elemente që e dallojnë atë nga gjykimi administrativ normal, në të cilin pala në proces nuk mundet të paraqesë akte në çdo kohë, rregullimi ligjor në këtë rast është i detyrueshëm, për të shmangur zvarritjen e gjykimit dhe përfundimin e tij brenda një afati të arsyeshëm. Ndërkohë që procesi i rivlerësimit në thelb ka si qëllim verifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të justifikojë me burimeve financiare të ligjshme pasurinë në pronësi, posedim apo përdorim. Për këtë arsye, kam mbajtur një qëndrim konsekuent përgjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, që subjekteve të rivlerësimit t’u jepet mundësia të sjellin prova bashkëlidhur ankimit apo parashtrimeve, në mënyrë që vendimmarrja të bazohet mbi një konstatim sa më të plotë të situatës faktike e, për rrjedhojë, të jetë sa më e drejtë.

Një element tjetër i veçantë i këtij procesi, është organizimi i tij në dy shkallë gjykimi, dhe vendimmarrja e Kolegjit është përfundimtare dhe me efekt të menjëhershëm, ku ligji nuk parashikon mundësinë për kthimin e çështjes për rigjykim. Në kuptim të dispozitave kushtetuese, përkatësisht nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon se: *[...] Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj [...]*, në gjykimin tim, Kolegji duhet të kishte pranuar në cilësinë e provës, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të qartësuar situatën faktike, si dhe të korrigojonte çdo gabim procedural të Komisionit dhe, në përfundim, të vendoste marrjen e këtyre akteve shkresore, të cilat do të kishin ndryshuar dukshëm situatën faktike dhe financiare të subjektit të rivlerësimit.

7. Një arsye tjetër është fakti se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2010 – 2015, të ardhurat nga bujqësia dhe turizmi në mënyrë kumulative. Në kushtet kur këto të ardhura nuk janë deklaruar të ndara, shumica e trupit gjykues, në pamundësi për të bërë ndarjen e tyre, duhet t’i jepte mundësinë subjektit të rivlerësimit, duke pranuar aktet/aktekspertimin e paraqitur prej tij, t’ia nënshtronte ato debatit gjyqësor, dhe kurrësi të konsideronte në vlerën zero të ardhurat nga bujqësia. Marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës, në vlerësimin tim, do të afektonte situatën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke e përmirësuar atë deri në kufijtë e zbatimit të parimit të proporcionalitetit, të parashikuar në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
8. Në përfundim, pavarësisht sa referuar më sipër në këtë mendim paralel, iu bashkova shumicës së trupit gjykues për zgjidhjen përfundimtare të çështjes për faktin se pasaktësitë në deklarime nga subjekti i rivlerësimit nuk qëndronin vetëm për të ardhurat nga bujqësia dhe hoteleri-turizmi, por mbi të gjitha mbi mosdeklarimin e një huaje në vlerën 18.594 USD, marrë nga z. A. K., në vitin 2011. Kjo hua e pretenduar nga subjekti si e marrë nga bashkëshortja e tij për shlyerjen e kredisë

pranë Credins Bank ShA, nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë në vitin 2011 dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, për më tepër kur analiza financiare e kryer, tregoi pamundësi të huadhënësit për dhënien e kësaj huaje në momentin e pretenduar, gjë e cila e kualifikon subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi